



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD  
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË E UJËSJELLËSIT DHE MBETURINAVE NË KOSOVË NË 2010

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar dhe kompanive të mbeturinave të ngurta



# Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Mbeturina

## Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurtë dhe efikente të ujësjetës dhe mbeturinave për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

## Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjetës dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË KOMPANIVE TË UJIT DHE MBETURINAVE NË KOSOVË PËR VITIN 2010

## PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse .....	v
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUM.....	vii

### **A FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET PËR UJËRAT E ZEZA ..... 1**

---

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
1.1	Korniza e re për monitorimin e performancës .....	3
1.2	Struktura e raportit për sektorin e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza .....	3
<b>2</b>	<b>Zhvillimet në sektor .....</b>	<b>5</b>
<b>3</b>	<b>Performanca e KRU .....</b>	<b>7</b>
3.1	Furnizimi me ujë .....	7
3.1.1	<i>Jo-financiare (teknike)</i> .....	7
3.1.2	<i>Jo-financiare (komerciale)</i> .....	10
3.1.3	<i>Financiare</i> .....	12
3.2	Shërbimet për ujërat e zeza.....	15
3.2.1	<i>Jo-financiare (teknike)</i> .....	15
3.2.2	<i>Jo-financiare (komerciale)</i> .....	16
3.2.3	<i>Financiare</i> .....	17
3.3	Performanca e KRU – Financiare .....	19
3.3.1	<i>Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave</i> .....	19
3.3.2	<i>Kthimi në kapital</i> .....	20
3.4	Performanca e përgjithshme e KRU .....	21
3.4.1	<i>Arsyeshmëria</i> .....	21
3.4.2	<i>Vlerësimi i performancës</i> .....	21
<b>4</b>	<b>Performanca e sektorit.....</b>	<b>25</b>
4.1	Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF .....	25
4.2	Mbulueshmëria me shërbime .....	26
4.3	Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar .....	26
4.4	Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale).....	27
<b>5</b>	<b>Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Ibër-Lepenci).....</b>	<b>28</b>
<b>6</b>	<b>Aktivitetet e KKK .....</b>	<b>29</b>
<b>7</b>	<b>Sfidat për të ardhmen .....</b>	<b>30</b>
<b>SHTOJCA 1</b>	<b>Të dhënat e detajuara të performancës.....</b>	<b>33</b>
<b>SHTOJCA 2</b>	<b>Definicionet dhe arsyeshmëria .....</b>	<b>48</b>
<b>SHTOJCA 3</b>	<b>Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave.....</b>	<b>55</b>
<b>SHTOJCA 4</b>	<b>Pasqyrat tarifore (2009 – 2011) .....</b>	<b>58</b>
<b>SHTOJCA 5</b>	<b>Detajet kontaktuese .....</b>	<b>59</b>
<b>SHTOJCA 6</b>	<b>Zonat e shërbimit të KRU .....</b>	<b>61</b>

### **B SEKTORI I MBETURINAVE..... 63**

---

<b>1</b>	<b>Zhvillimet në sektorin e mbeturinave.....</b>	<b>65</b>
<b>2</b>	<b>Performanca e përgjithshme e sektorit të mbeturinave .....</b>	<b>66</b>

2.1	Metodologjia e vlerësimit të performancës .....	66
<b>3</b>	<b>Performanca krahasuese e kompanive të grumbullimit të mbeturinave.....</b>	<b>69</b>
3.1	Performanca teknike .....	69
3.1.1	<i>Grumbullimi i mbeturinave për punëtor .....</i>	<i>69</i>
3.1.2	<i>Mbeturinat e deponuara në deponitë e licensuara .....</i>	<i>69</i>
3.1.3	<i>Efikasiteti i stafit .....</i>	<i>70</i>
3.2	Performanca e nivelit të shërbimit .....	71
3.2.1	<i>Mbulueshmëria me shërbime .....</i>	<i>71</i>
3.2.2	<i>Ankesat e konsumatorëve.....</i>	<i>71</i>
3.3	Performanca financiare .....	72
3.3.1	<i>Shpenzimet operative për njësi.....</i>	<i>72</i>
3.3.2	<i>Shkalla e arkëtimit .....</i>	<i>72</i>
3.3.3	<i>Norma e punës .....</i>	<i>73</i>
3.3.4	<i>Norma e mbulimit të punës .....</i>	<i>73</i>
<b>4</b>	<b>Performanca e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.....</b>	<b>75</b>
<b>5</b>	<b>Sfidat për të ardhmen .....</b>	<b>76</b>
<b>SHTOJCA 1</b>	<b>Të dhënat e detajuara të performancës .....</b>	<b>77</b>
<b>SHTOJCA 2</b>	<b>Informata mbështetëse .....</b>	<b>82</b>
<b>SHTOJCA 3</b>	<b>Tarifat për grumbullimin e mbeturinave .....</b>	<b>84</b>
<b>SHTOJCA 4</b>	<b>Detajet kontaktuese .....</b>	<b>85</b>
<b>SHTOJCA 5</b>	<b>Zonat e shërbimit të KRM.....</b>	<b>87</b>

## Akronimet dhe shkurtesat

AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
AZZB	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
BE	Bashkimi Evropian
FE	Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujit Radoniqi (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IL	NH Ibër Lepenci
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau – Banka Gjermane për Zhvillim
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
TFU	Taskë Forca e Ujit
UPF	Uji i pa-faturuar
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina
ZZB	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim





## FJALA HYRËSE



Kam kënaqësinë të publikoj këtë raport të pestë vjetor të performancës për kompanitë e licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, shitjes së ujit me shumicë dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë për vitin 2010.

Në këtë raport është paraqitur një kornizë dukshëm më e përmirësuar për matjen e performancës në sektorin e ujit, duke u fokusuar në ato aspekte që ndikojnë direkt ose indirekt mbi konsumatorët, p.sh. nivelet e shërbimit, eficientën e kostos dhe eficientën komerciale. Përveç kësaj ne kemi shfrytëzuar rastin që të krahasojmë performancën e Kompanive Rajonale të Ujit (KRU) kundrejt performancës së planifikuar, ashtu siç është përcaktuar në aplikacionet e tyre tarifore për Rishikimin Tarifor 2009-2011.

Në katër vitet e para që ZRRUM ka matur performancën e sektorit të ujit, është treguar një përmirësim i përgjithshëm prej vitit në vit, mirëpo me një ritëm shumë të ngadaltë (dhe sektori i ujërave të zeza nuk është përmirësuar fare). Për fat të keq, në përgjithësi performancat e KRU për vitin 2010 janë shumë më dobët se parashikimet/pritjet, me vetëm disa fusha që tregojnë përmirësime të dukshme krahasuar me 2009. Humbjet e ujit janë më të lartat që janë regjistruar ndonjëherë, të një sasive prej 83 milion m<sup>3</sup> në vit, situatë kjo e papranushme kur dihet se furnizimi me ujë për konsumatorët është i pamjaftueshëm (d.m.th. 24 orë furnizim); shpeshësia e plasaritjeve të gypave dhe bllokimi i kanalizimeve/vërshimeve janë shumë të larta dhe në disa raste është në rritje; ndërprerjet e furnizimit janë ende shumë më të larta sesa që duhet të jenë; dhe ankesat janë në rritje, duke reflektuar përkeqësimin e performancës. Fusha e vetme që ka shënuar përmirësim të dukshëm gjatë vitit 2010 është mbulueshmëria me shërbime të ujit, mirëpo pa investime paralele në prodhimin e ujit kjo është duke rezultuar në efekte më të mëdha që kanë të bëjnë me shtimin e kërkesës për propocionalizimin e ujit dhe në ndërprerje të furnizimit. Eficienta në arkëtim po ashtu është përmirësuar dukshëm në disa kompani, duke përfshirë KRU Prishtina (Prishtinë), KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren) dhe KRU Hidromorava (Gjilan) ku tashmë kanë filluar të tregojnë rezultate politikave të shqyrcjeve. Performanca e matur në terma absolute sugjeron që kompania e ujësjellësit dhe shërbimeve të ujërave të zeza me performancën më të mirë në Kosovë arrin në më pak se 60% nga çfarë do të pritej nga një kompani 'ideale'. Unë nuk pres që të arrihet 'idealja' nën kushtet e përgjithshme aktuale ekonomike në Kosovë por një cak prej rreth 80% do ta konsideroja si 'ideal', e që do të ishte një ambicie reale afatshkurtër në Kosovë. KRU kanë një rrugë të gjatë për të bërë e për të arritur këtë aspiratë modeste.

Performanca aktuale krahasuar me performancën e planifikuar është akoma më e dobët. Edhe pse arkëtimi i të ardhurave është përmirësuar pak, prapë se prapë është dukshëm më i ulët se sa që ishte planifikuar. Kjo ka rezultuar që investimet aktuale të jenë më të ulëta se 10% (rregulluar për normën e inflacionit)<sup>1</sup> nga sa ishin planifikuar dhe aprovuar nga ZRRUM në procesin e mëparshëm të rishikimit tarifor, shumica prej tyre kanë qenë investime të realizuara nga donatorët sesa nga KRU. Edhe pse përmendet si shkak kryesor për dështim në arritjen e investimeve dhe arritjen e caqet për nivelet e shërbimit, unë besoj që përmirësimi në arkëtimin e të ardhurave është një fushë që kontrollohet direkt nga KRU dhe në rastin e dështimit për të arritur nuk mund plotësisht të fajësohen konsumatorët që janë të kyçur ilegalisht ose që nuk dëshirojnë të paguajnë. Unë besoj që KRU nuk janë duke bërë aq sa duhet që të arkëtojnë borxhet e tyre. Unë i inkurajoj të gjitha KRU që të jenë më të drejtëpërdrejta në aktivitetet e tyre që kanë të bëjnë me arkëtimin e të ardhurave duke përfshirë edhe zbatimin e politikave të drejta të shqyrcjeve. Pa këto mjete financiare KRU janë të pafuqishme që të jenë të gjendje që të përmbushin nivelin e tyre të shërbimit si dhe detyrimet për investime.

<sup>1</sup> Investimet kapitale aktuale në bazë të çmimeve nominale kanë qenë 12% krahasuar me ato të planifikuara (çmimet e mesit të vitit 2008). Investimet kapitale të financuara nga donatorët kanë qenë për 11% krahasuar me atë të planifikuar (poashtu bazuar në çmimet e mesit të vitit 2008).

Shërbimet e limituara të ujërave të zeza, që përfshijnë vetëm grumbullimin e ujërave të zeza, janë një fushë me nevojë më të madhe për mbështetje dhe investime. Pa asnjë impiant për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë niveli i shërbimit është shumë më i ulët se që pritet të jetë në një ambient Evropian. E pranoj se kjo nuk mund të arrihet brenda natës, e as investimet e mëdha nuk mund të financohen drejtëpërdrejtë nga burimet vetanake të KRU. Kosova ka nevojë për investime të mëdha kapitale të jashtme në këtë sektor e me mbështetje të komunitetit të agjencive zhvillimore.

Rishikimi i ardhshëm tarifor 2012 - 2014 është një mundësi për KRU që të zgjidhin shumicën e problemeve e kjo përmes përgatitjes së biznes planeve rregullatore mirë të menduara e të bazuara në caqe sfiduese por gjithësesi reale dhe të arritshme të performancës dhe investimeve. Konsumatorët e Kosovës nuk mund të përballojnë një përsëritje të rishikimit të fundit tarifor e ku caqet u provuan si jo reale dhe KRU dështuan të përmbushin pothuajse të gjitha detyrimet e tyre. Unë besoj që në mënyrë profesionale dhe metodike KRU do të nxjerrin mësim nga kjo sfidë.

Përfundimisht, pas 5 vitesh të monitorimit të performancës nga ZRRUM është e kohës që të shtrohet pyetja fundamentale: përkundër niveleve të larta të investimeve kapitale nga donatorët dhe projekteve për ngritje institucionale, si në të kaluarën por edhe në ditët e sotme, pse ka kaq pak dëshmi se KRU janë duke përmirësuar performancën e tyre? Një çështje kyçe është mungesa e stimuljeve financiar për personelin e KRU. Unë kam tentuar të e adresojë këtë mungesë të motivimit përmes inkurajimit për përdorim të një skeme të thjeshtë, vetë-financuese për të gjithë personelin e KRU. Tashmë i takon Qeverisë së Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si pronare e aseteve, si dhe KRU që të zhvillojnë dhe zbatojnë së bashku mekanizimin e propozuar.

Sektori i mbeturinave vazhdon të ketë performancë të dobët dhe performanca në 2010 tregon pak përmirësime krahasuar me vitin 2009. Përmirësimi është evident në shkallën e arkëtimit, megjithatë shkalla prej 61% është shumë e ulët dhe nënkupton se ky sektor mbetet ende në gjendje të pakënaqshme financiare. Në mënyrë të veçantë unë jam i zhgënjyer që kompanitë e mbeturinave kanë paguar vetëm 12% të pagesave vjetore të licensimit të ngarkuara nga ZRRUM në vitin 2010. Sidoqoftë, unë pres në marrjen e vendimit nga Kuvendi i Kosovës lidhur me licensimin e ardhshëm si dhe aranzhimet për përcaktim e tarifave për kompanitë e licensuara të mbeturinave, e që kjo pritet të ndodh së shpejti.

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 08 Qershor 2011, ZRRUM pret bashkëpunim nga KRU dhe KRM, si dhe përkrahje nga Njësia për Politika dhe Monitorim e NP, sa i përket inkorporimit të komunave të reja në zonën e shërbimit të KRU dhe KRM si dhe ri-inkorporimin e atyre që kanë vendosur, njëanshem, të shkëputen nga kompanitë rajonale.

Edhe pse të dhënat në këtë raport sigurojnë reflektim të drejtë të performancës ne besojmë se të dhënat që janë siguruar në ZRRUM nuk janë perfekte. Ne i nxisim KRU dhe KRM të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit të të dhënave me qëllim të rritjes së saktësisë dhe besueshmërisë së raporteve të performancës në të ardhmen.

Informacionet e prezantuara në këtë raport janë në interes të konsumatorëve, menaxherëve të KRU dhe KRM, investitorëve, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dijnë se si kompanitë e tyre respektive dhe sektori i ujit dhe mbeturinave po performojnë. Ne besojmë se Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës do të marrin masa për përmirësimin e performancës së këtyre sektorëve në të ardhmen.

Së fundi, unë dëshiroj të falënderoj stafin e ZRRUM dhe të gjithë ata që e mbështetën dhe janë duke ofruar mbështetje për ZRRUM. Në veçanti, do të doja të falënderoj Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) për ndihmën e dhënë në përgatitjen e këtij raporti, përmes mbështetjes së dhënë nga IPA<sup>2</sup>- kryesuese e konsorciumit të Konsulentëve si pjesë e 'Projektit për Mbështetje të Mëtejshme për Forcimin Institucional të ZRRUM'



Drejtor i ZRRUM

Korrik 2011

---

<sup>2</sup> Që përbëhet nga IPA Energy+Water Economics, RODECO Consulting GmbH dhe Edinburgh Economics

# ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM) është themeluar në vitin 2004 përmes Rregullorës së UNMIK 2004/49 e cila më pas është zëvendësuar me Ligjin Nr. 03/L-086 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor 2008. Në pajtueshmëri me këtë Ligj, ne raportojmë aktivitetet tona dhe jemi llogaridhënës para Kuvendit të Kosovës.

Roli jonë si rregullator ekonomik për sektorët e furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta është për të siguruar se ofruesit e rregulluar të shërbimeve (ofruesit e shërbimeve të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza dhe të mbeturinave të ngurta, të cilët janë në pronësi publike dhe shoqërore), nuk i keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste duke u siguruar që ato ofrojnë një standard të arsyeshëm të shërbimit me një çmim të drejtë dhe se të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe ato të konsumatorëve të tyre, janë të balancuara në mënyrë të drejtë dhe që të njëjtat zbatohen. Për të arritur këtë rol ne ndërmarrim këto aktivitete kryesore:

- Përcaktimin e tarifave në nivele të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e obligueshme të shërbimit dhe në nivel të pranueshëm të pritjeve për shërbime, por në të njëjtën kohë duke promovuar efikasitetin për të siguruar që çmimet nuk janë më të larta se sa që ato duhet të jenë;
- Duke siguruar që ofruesit e shërbimeve përmbushin obligimet e tyre në lidhje me nivelin e shërbimeve;
- Licensimin e ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të mbeturinave;
- Stimulimin e konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit (benchmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e licensuar të shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste dhe duke siguruar që shërbimet e ofruara janë në përputhje me standardet e vendosura e të përshtatshme të shërbimeve;
- Krijimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve;
- Sigurimin e një mekanizmi për konsumatorët që të parashtrajnë ankesa ndaj ofruesve të shërbimeve përmes Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) dhe në fund edhe drejtëpërdrejtë në ZRRUM.

Në pajtim me praktikën e mirë rregullatore, qasja jonë është e orientuar drejt rezultateve konkrete. Kryesisht interesohemi në lidhje me nivelet e shërbimit dhe shpenzimet e përgjithshme. Pra, ne nuk ndërhyjmë drejtëpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licensuar të shërbimeve, duke e lënë këtë përgjegjësi për menaxhmentet si dhe bordet e ofruesve të shërbimit. Për më tepër, nuk kemi asnjë juridiksion mbi furnizimet private me ujë, prodhuesve të ujit në shishe ose operatorëve që nuk janë në pronësi publike e që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë zonave të definuara të furnizimit të NP, p.sh. furnizimi me ujë në zonat rurale. Në mënyrë të ngjashme, ne nuk kemi juridiksion rregullator mbi disa prej operatorëve joformal privat për grumbullimin e mbeturinave.

Ne nuk jemi përgjegjës për vendosjen e standardeve të cilësisë së ujit të pijshëm ose për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Kjo është përgjegjësi e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP). Megjithatë ne punojmë për së afërmi me IKSHP, veçanërisht në shkëmbimin e të dhënave që kanë të bëjnë me respektimin e niveleve të përcaktuara për cilësinë e ujit dhe kemi një Marrëveshje Mirëkuptimi me IKSHP.

Në mënyrë të ngjashme, ne nuk jemi përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM). Megjithatë, qasja jonë është për të siguruar që politikat dhe procedurat tona nuk dëmtojnë mjedisin dhe shëndetin publik dhe ku është e mundur ne bashkëpunojmë ngushtë me rregullatorët tjerë.



# A FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET PËR UJËRAT E ZEZA

---



# 1 HYRJE

---

## 1.1 Korniza e re për monitorimin e performancës

Në këtë raport matja e performancës së KRU nëse krahasohet me raportet e mëparshme të performancës thelbësisht është e ndryshme. Rezultatet të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë osë tërthorazi në konsumatorë janë ato të cilat ne jemi fokusuar në këtë raport, p.sh. cilësia e ujit, besueshmëria e shërbimit, efienca e kostos, etj., dhe nuk jemi fokusuar në ata tregues që për menaxherët mund të konsiderohen të rëndësishëm, e të cilët tregues jo domosdoshmërisht do të ishin të rëndësishëm edhe për konsumatorët. Përveç kësaj ne kemi kërkuar që të harmonizojmë kornizën e raportimit (bazën e të dhënave, treguesit dhe definicionet) me mjete të tjera rregullative të përdorura nga ZRRUM, përkatësisht me: Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit, duke përfshirë modelin për Planifikimin e Biznesit dhe Modelin tarifor. Kjo është e nevojshme për të matur performancën jo vetëm kundrejt viteve të kaluara, por, që është më e rëndësishme, kundrejt caqeve të dakorduara të performancës në aplikacionet tarifore, në këtë rast fjala është për Rishikimin Tarifor 2009-2011. Këto aplikacione, si dhe tarifatat e dakorduara, efektivisht përbëjnë një lloj kontrate ndërmjet çdo KRU dhe konsumatorëve që e njëjta u ofron shërbime; dmth një çmim i dakorduar në këmbim me marrjen përsipër të detyrimit për të ofruar një nivel të caktuar të shërbimit.

Dallimi tjetër në krahasim me vitet e kaluara, është matja e performancës në baza absolute (kundrejt asaj krahasuese) e ku performanca matet kundrejt një kompanie 'ideale' që ofron shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet për ujëra të zeza dhe e cila është në gjendje të: ofrojë shërbime për të gjithë, të respektojë në plotësi standardet e shërbimit, operojë sipas niveleve maksimale të eficientës së kostos dhe në të njëjtën kohë të gjenerojë një rrjedhë të të ardhurave që është e mjaftueshme për ofruesin e shërbimit për të financuar aktivitetet si dhe investimet e nevojshme.

Për qëllime krahasuese në këtë raport vjetor të gjitha të dhënat financiare janë konvertuar në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2010, duke përdorur të dhënat statistikore për inflacionin në Kosovë. Kjo është mëse e nevojshme për të bërë krahasimin e performancës financiare nga viti në vit.

Ne besojmë se ndryshimet e paraqitura më sipër sigurojnë një kornizë shumë më të përmirësuar për matjen e performancës dhe mundësojnë një shikim më të thellë për nevojat e sektorit. Për më tepër, kjo kornizë do të ofrojë udhëzime për drejtuesit e KRU (dhe bordet e tyre) në përcaktimin e prioriteteve të tyre në terma afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata. Ne gjithashtu besojmë se kjo kornizë e përmirësuar do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në formulimin e politikave sektoriale. Shpresojmë se investitorët, e në veçanti, agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit do të përdorin këtë raport për të identifikuar, përcaktuar prioritete dhe vlerësuar projektet dhe programet investuese.

## 1.2 Struktura e raportit për sektorin e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza

Ky raport hapet me një pasqyrim të zhvillimeve në sektorët e ujit dhe të ujërave të zeza (kapitulli 2 Zhvillimet në sektor), duke përfshirë: debatin aktual në lidhje me strukturën e sektorit dhe rolin e komunave; zhvillimet e fundit (dhe implikimet e tyre) në sektorin e ujërave të zeza; instrumentet e reja ligjore; përfshirjen e komunave të reja në kuadër të kompanive rajonale të ujit; efektet negative të shpërbërjes së KRU; Rishikimin e ardhshëm Tarifor për 2012 - 2014; programet mbështetëse aktuale dhe të planifikuara.

Thelbi i këtij raporti vazhdon me (kapitulli 3 Performanca e KRU) ku ne ofrojmë informacione, analiza dhe komente për performancën e shtatë KRU. Në këtë analizë, ne shqyrtojmë performancat relative të KRU në lidhje me shërbimet e furnizimit me ujë, shërbimet për ujërat e zeza dhe menaxhimin financiar / komercial. Ky kapitull përfundon me vlerësim të performancës së përgjithshme në bazë të indeksit të ri të performancës në raport me nivelin ideal të performancës.

Në vazhdim të raportit është e paraqitur pasqyra e performancës së sektorit në pesë vitet e fundit (kapitulli 4 Performanca e sektorit) ku ne shqyrtojmë aspekte të tilla si: uji i prodhuar, shitjet dhe UPF (uji i pa-faturuar), të hyrat dhe arkëtimi i të ardhurave dhe shpenzimet kapitale.

Më tej në raport shqyrtohet dhe diskutohet performanca e furnizuesit të vetëm që furnizon me shumicë ujë të patrajtuar (kapitulli 5 Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Ibër-Lepenci)).

Në vazhdim raportohet mbi rolin e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) (kapitulli 6 Aktivitetet e KKK).

Në fund të raportit paraqesim mendimet tona në lidhje me sfidat e së ardhmes për sektorin në Kosovë (kapitulli 7 Sfidat për të ardhmen), në veçanti nevojën për KRU për të marrë më seriozisht obligimet e tyre të investimeve të përcaktuara në biznes planet e tyre rregullatore.

Pas tekstit kryesor të raportit ne ofrojmë informacione shtesë, përmes një serie të shtojcave, duke përfshirë: të dhëna të detajuara të performancës për secilën KRU; informacione tjera mbështetëse (definicionet dhe arsyeshmëritë); pasqyrat financiare; pasqyrat tarifore; dhe detajet e kontaktit.



## 2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

### *Struktura aktuale e sektorit të ujit në Kosovë*

Praktika e mirë rregullatore mbështet ndarjen e qartë të roleve të tre organeve kryesore të përfshira në sigurimin e ofrimit të shërbimeve të duhura për konsumatorët. Këto organe përbëhen nga Qeveria (që merret me përcaktimin e politikave dhe legjislacionit sektoral nëpërmjet prezantimit të ligjeve të nevojshme), rregullatori ekonomik (që përcakton tarifat dhe mbron interesat e konsumatorëve), dhe ofruesit e shërbimeve (që ofrojnë shërbime të arsyeshme për konsumatorët).

Struktura aktuale e sektorit të ujit dhe të ujërave të zeza në Kosovë, përbërë nga shtatë kompani rajonale të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza, të cilat janë të rajonalizuara në bazë të kufijve të ujëmbledhësve lumor dhe me ekonomi të konsiderueshme të shkallës, rregullohet nga rregullatori i pavarur (ZRRUM) i themeluar sipas Ligjit Nr 03/L-086 dhe i cili është llogaridhënës ndaj Kuvendit të Kosovës, i cili plotësisht i përmbush këto kritere. Në fakt sektori i ujit në Kosovë është më i përparuar se sa në vendet e tjera në rajonin e Ballkanit në lidhje me efikasitetin, llogaridhënien, dhe pajtueshmërinë me standardet Evropiane.

Megjithatë, si pjesë e procesit të decentralizimit në Kosovë, ka pasur debat të konsiderueshëm mbi rolin e ardhshëm të komunave në sektorin e ujit, kryesisht si rezultat i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, i cili reflekton rekomandimet e mëparshme të pakos së Ahtisaarit ku thuhet se komunat *ndër të tjera* janë përgjegjëse për *“ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave”*. Se si do të arrihet kjo, e në të njëjtën kohë të ruhet struktura aktuale rajonale e kompanive të ujit dhe rregullatori i pavarur, aktualisht është e paqartë dhe është subjekt i debatit.

ZRRUM në mënyrë aktive ka qenë i përfshirë, së bashku me akterët e tjerë, rishqyrtimin e Marrëveshjes për Shërbime në mes të KRU dhe komunave për të rritur rolin e komunave dhe ka kontribuar në zhvillimin e draft raportit të paraqitur në konferencën e organizuar nga TFU / SDC më 6 Qershor 2011 mbi roli e ardhshëm të komunave në sektorin e ujit. Raporti përfundimtar i dalë nga kjo konferencë është në disponim të publikut<sup>3</sup>. Propozimet kryesore që janë duke u konsideruar nga Qeveria e Kosovës, dhe që mbështeten nga ZRRUM, parashikojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunave në Bordet e KRU si dhe një rol më të theksuar për komunat në fusha të caktuara, duke përfshirë çështjet në lidhje me planifikimin përmes Marrëveshjes së rishikuar të Shërbimit. Në mënyrë që këto propozime të reja të mund të zbatohen do të jenë të nevojshme instrumente të reja dhe/ose ndryshime të instrumenteve ekzistuese ligjore.

### *Ujërat e zeza*

ZRRUM ka kërkuar nga KRU që të ndajnë shpenzimet e tyre në mes të qendrave të të ardhurave: furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza, në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie/përgjegjësi e duhur dhe për të siguruar tarifa që reflektojnë koston reale. Tarifat për shërbimet e ujërave të zeza janë të ulëta dhe reflektojnë situatën aktuale në Kosovë, ku shërbimi i vetëm i ofruar është ai i grumbullimit të ujërave të zeza<sup>4</sup>. Megjithatë, ka plane për investime të mëdha në të ardhmen në objekte të ujërave të zeza urbane e të cilat tashmë janë në fazën e studimit të fizibilitetit për disa nga kompanitë më të mëdha të ujit. Këto investime janë parashikuar që do të financohen kryesisht nga agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit përmes granteve dhe kredive të buta. Është e ditur se edhe pse janë të nevojshme investime të tilla në Kosovë, investime të cilat do t'i mundësonin Kosovës të përmbushë detyrimet e saja mjedisore afatgjata, ndikimi pasues në konsumatorë, krahasuar me nivelet aktuale të ulëta të tarifave, do të jetë një ngritje domethënëse, e domosdoshme dhe reale e tarifave për shërbimet e ujërave të zeza.

<sup>3</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/tfu/repository/docs/Final\\_Report\\_WTF\\_Kosovo\\_June\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/tfu/repository/docs/Final_Report_WTF_Kosovo_June_2011.pdf).

<sup>4</sup> Në Kosovë nuk ka impiante të mëdha publike për trajtimin e ujërave të zeza, përveç një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Skënderaj, por i cili impiant ende nuk është komisionuar.

### ***Ndryshimet në instrumentet ligjore të ZRRUM***

ZRRUM, kohëve të fundit ka rishikuar disa nga Rregullat e saj, duke përfshirë Rregullën mbi Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve dhe Rregullën për Standardet e Shërbimit, dhe pas konsultimeve statutores me grupet e interesit, janë lëshuar Rregullat e rishikuara dhe të përditësuara. Rregulla e rishikuar e KKK përfshinë një përkufizim më të qartë të rolit të anëtarëve të KKK dhe një rol më të zgjeruar të komunave në lidhje me propozimin e kandidatëve të KKK në ZRRUM.

### ***Ofrimi i shërbimeve të ujit për komunat e reja***

Kohët e fundit janë krijuar disa komuna të reja të cilat kanë sisteme ekzistuese ose të reja për furnizim me ujë. Këto komuna të reja do të duhet të integrohen në zonën përkatëse të përgjegjësisë së KRU e që për këtë nevojitet adoptimi i këtyre sistemeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza nga ana e KRU. ZRRUM është duke i vizituar këto komuna të reja për të lehtësuar integrimin e këtyre sistemeve të ujit në zonën përkatëse të përgjegjësisë së KRU.

### ***Tërheqja e sistemeve komunale të ujit nga Kompanitë Rajonale të Ujit***

Vitet e fundit disa komuna, duke përfshirë atë të Kaçanikut dhe Deçanit kanë tërhequr sistemet e tyre të ujit, në mënyrë të paligjshme dhe njëanshme, nga struktura e kompanive rajonale të ujit.

### ***Përcaktimi i tarifave***

Në përputhje me praktikën më të mira rregullatore në fund të vitit 2007 është prezantuar një ndryshim rrënjësor sa i përket mënyrës së përcaktimit të tarifave dhe e njëjta metodologji është e aplikueshme gjatë periudhës tarifore aktuale tre vjeçare 2009-2011. Qasja aktuale e përcaktimit të tarifave shumëvjeçare është përmirësuar (përmes përkrahjes teknike të siguruar nga Konsulentët e financuar nga BE dhe menaxhuar nga ZNKE) me qëllim të caktimit të tarifave për periudhën e ardhshme trevjeçare (2012 - 2014).

### ***Mbështetja për sektorin***

Konsulentët e financuar nga donatorë ndërkombëtarë duke përfshirë Bashkimin Evropian, Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim, KfW, USAID, Agjencinë e Luksemburgut për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe Bankën Botërore gjatë disa viteve të fundit kanë vazhduar në sigurimin e mbështetjes së rëndësishme për KRU dhe ZRRUM dhe kjo mbështetje ka të ngjarë të vazhdojë edhe gjatë disa viteve të ardhshme, me një fokusim të mbështetjes institucionale dhe investimeve kapitale në impiante për trajtimin e ujit dhe impiante për trajtimin e ujërave të zeza.

## 3 PERFORMANCA E KRU

Kjo pjesë e raportit fokusohet në treguesit kryesor të performancës që ndikojnë drejtpërdrejtë në shërbimet ofruar konsumatorëve. Një ekzaminim më i hollësishëm i performancës që përfshin shumë tregues që nuk përmenden në tekstin kryesor të këtij raporti është paraqitur në SHTOJCA 1.

### 3.1 Furnizimi me ujë

Ky nën-sesion analizon performancën e shtatë KRU në lidhje me shërbimet e furnizimit me ujë në vitin 2010 dhe krahason performancën e vitit 2010 me atë të viteve të mëparshme dhe poashtu kundrejt caqeve / pritjeve që kanë qenë të përfshira në rishikimin tarifor 2009-2011. Ne nën-ndajmë këtë analizë në tre sesione kryesore: jo-financiare (teknike), jo-financiare (komerciale) dhe financiare.

#### 3.1.1 Jo-financiare (teknike)

Ky nën-sesion fokusohet mbi aspektet teknike të furnizimit me ujë të tilla si cilësia, nivelet e shërbimit etj., me një fokusim në ato aspekte që ndikojnë drejtpërdrejtë në konsumatorë.

##### *Standardet e shërbimit*

Standardet kryesore të shërbimit për furnizim me ujë janë: furnizimi i **vazhdueshëm** me ujë me një shtypje të pranueshme dhe uji i furnizuar të jetë në pajtim me standardet statutorë të **cilësisë**.

##### *Cilësia e ujit*

Cilësia e ujit është e rregulluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) (në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë). Standardet, kundrejt të cilave matet pajtueshmëria e testeve të ujit, janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 2/1999, i cili pjesërisht është i bazuar në Direktivën e BE për Ujin e Pijshëm (1998)<sup>5</sup>. Ky raport riprodhon informacionin e siguruar nga IKSHP.




Figura A - 1 Rezultatet e testimit të cilësisë së ujit

Figura A - 1 e paraqitur më lartë ilustron rezultatet e testeve të cilësisë së ujit për vitet 2009 dhe 2010. Edhe pse normat e kalueshmërisë që tejkalojnë shifren prej 90% duken mbresëlënëse ato janë shumë më të ulëta se normat e pranuar ndërkombëtare, të cilat pritet që të tejkalojnë normën e kalueshmërisë së testeve prej 99%. Një normë e kalueshmërisë prej 90% (sidomos për testet

<sup>5</sup> IKSHP është duke e rishqyrtuar Udhëzimin Administrativ 2/1999 me qëllim të zhvillimit të standardeve të reja, të cilat do të jenë në pajtim me Direktivën e BE për Ujin e Pijshëm.


bakteriologjike) ende paraqet një nivel të papranueshëm të rrezikut për konsumatorë që ata të marrin sëmundje si pasojë e sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse merren parasysh ndërprerjet e furnizimit të rregullt me ujë që janë të pranishme, e gjatë së cilës kohë sistemi i furnizimit rrezikohet nga kontaminimi. Ne besojmë se KRU, në veçanti KRU Bifurkacioni (Ferizaj), KUR Hidrodriini (Pejë) dhe KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren), ende kanë shumë për të bërë për të siguruar që konsumatorët e tyre të kenë besim sa i përket cilësisë së ujit të furnizuar nga KRU e tyre, tregues i suksesit do të ishte edhe rënia e blerjes së ujit në shishe që është një dukuri shumë e përhapur.

### Shtypja

Për këtë raport të performancës për vitin 2010 ne e kemi parë të arsyeshme që shtypja e ujit të përfshihet si tregues i performancës, i cili definohet si numri i pronave që ndikohen, rregullisht, nga shtypja e ulët (nën 7m në pikën e furnizimit<sup>6</sup>). Jo të gjitha KRU kanë dhënë informacionin e nevojshëm për këtë vlerësim dhe për ato që kanë paraqitur të dhënat e kërkuara ka dyshime mbi besueshmërinë e informacionit të dhënë<sup>7</sup>. Pavarësisht shqetësimeve të tilla, informacionet e pranuar sugjerojnë se ka probleme të vogla në lidhje me shtypjen e ujit, ku shumica e KRU kanë raportuar shifër më të ulët se 5% të konsumatorëve që kanë shtypje të ulët të furnizimit me ujë. Sidoqoftë ky fakt nuk duhet të jetë një shkak për vetëkënaqësi dhe KRU duhet të përpiqen që të përmirësojnë shtypjen në rastet kur ajo është nën nivelet e parapara minimale. Në raportet e ardhshme të performancës ne presim që me në hollësi të raportojmë për shtypjen e furnizimit me ujë.

### Disponueshmëria

Në përgjithësi furnizimi me ujë në Kosovë është subjekt i kufizimeve të bilancit të furnizimit/kërkesës të cilat shpesh limitojnë shërbimin ideal të furnizimit me ujë në më pak se 24 orë në ditë. Në të kaluarën ne kemi raportuar performancën mbi bazën e mesatares së orëve me furnizim në ditë. Për dallim nga raportet e kaluara treguesi i përdorur për matjen e performancës në këtë raport është rishqyrtuar për të pasqyruar numrin e pronave të prekura/ndikuara nga disponueshmëria (të ndara në tre kategori të pronave: me 24 orë shërbim në ditë, 18-23 orë shërbim në ditë dhe ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë). Sa i përket shtypjes, të dhënat e performancës nga KRU nuk janë të plota (KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren) nuk i ka raportuar të dhënat). Të dhënat për vitin 2009 janë diskutabile dhe nuk janë marrë parasysh në këtë analizë.



**Figura A - 2 Besueshmëria e shërbimit (2010) e paraqitur si numri i konsumatorëve të ndikuar nga ndërprerjet e rregullta të furnizimit me ujë<sup>8</sup>**

Figura A - 2 ilustron nivelin aktual të shërbimit sipas treguesit të ri të performancës. Edhe pse KRU Prishtina (Prishtinë) në shumë pjesë të qytetit është duke siguruar furnizim prej më pak se 18 orë në ditë është e ditur se programi aktual i investimeve të kësaj kompanie është projektuar për të trajtuar këtë dhe probleme të tjera. Posa këto investime të jenë komisionuar ne presim që niveli i shërbimit do të

<sup>6</sup> Në pajtim me Rregullën e ZRRUM për Standardet Minimale të Shërbimeve, ZRRUM 2010

<sup>7</sup> Për qëllime të matjes së përgjithshme të performancës për furnizim me ujë, pesha e treguesit të shtypjes është 5%. Për ato KRU të cilat nuk kanë raportuar të dhënat e kërkuara për këtë tregues është alokuar poentimi prej 0%, e kjo është bërë për t'u siguruar që në raportet e ardhshme do të ofrohen të dhëna të sakta dhe të besueshme.

<sup>8</sup> KUR Hidroregjioni Jugor (Prizren) nuk ka raportuar të dhëna për këtë tregues të performancës.

përmirësohet dukshëm. Sa i përket kompanive tjera ne u bëjmë thirrje atyre që të përmirësojnë besueshmërinë në shërbime, të përpiqen që të ofrojnë furnizim të vazhdueshëm për të gjithë konsumatorët gjatë tërë vitit. Për t'u arritur kjo, ne presim që aplikacionet e ardhshme tarifore do të pasqyrojnë provizionimet për investime në resurse të ujit dhe kapacitetet prodhuese, por duhet pasur parasysh edhe implikimet tarifore dhe çfarëdo kufizimi në lidhje me përbalueshmërinë.

### Shërbyeshmëria infrastrukturore


Shërbyeshmëria infrastrukturore është aftësia e aseteve për të ofruar nivelet e kërkuara të shërbimit, dështimet e të cilave i atribuohen plasaritjes (dëmtimit) së gypave dhe humbjeve të ujit.

#### Plasaritjet e gypave

Plasaritjet e gypave me të cilat janë ballafaquar KRU (matur si numri i plasaritjeve për 100 km të gypit në vit) përgjithësisht janë të larta në mbi 70 sosh për 100 km gyp (mesatare e pa-ponderuar), duke filluar nga në më pak se 20 (KRU Hidrodrini (Peja)) në pothuajse 200 (KRU Bifurkacioni (Ferizaj)). Ndryshueshmëria e madhe në rezultate, së bashku me interpretimet e mundshme të ndryshme të asaj se çfarë është një plasaritje (dëmtim) rezulton në atë që një analizë krahasuese në masë të madhe të jetë e pavlefshme. Ky numër i lartë i plasaritjeve (dhe si rrjedhojë humbjeve) lehtësisht mund të jetë manifestim i shpenzimeve të kufizuara në mirëmbajtje kapitale (ripërtëritje infrastrukturore) të rrjetit të furnizimit me ujë. Për më shumë detaje ju lutem referojuni nën-sesionit 3.1.3.

#### Uji i pa-faturuar


Uji i pa-faturuar (UPF) është llogaritur si diferenca midis vëllimit të ujit të prodhuar dhe vëllimit të ujit të shitur. Niveli absolut i UPF në Kosovë është rritur nga 78 milionë m<sup>3</sup> që ishte në vitin 2009 në mbi 83 milion m<sup>3</sup> në vitin 2010 (shih Figura A - 3). Edhe më shumë zhgënjyese është fakti se niveli i UPF është në nivelin më të lartë të regjistruara në pesë vitet e fundit (sipas të dhënave nga e kaluara në 2006 niveli i UPF ishte pak më i ulët se 83 milionë m<sup>3</sup> përderisa në 2008 ishte 73 milion m<sup>3</sup>). Ne sugjerojmë kujdes në interpretimin e këtyre rezultateve sepse aktivitetet që do të ndërmerreshin për reduktimin e humbjeve duhet të jenë të balancuara me shpenzimet dhe përfitimet. Për shembull, shërbimi i furnizimit me ujë në KRU Hidrodrini (Pejë) është kryesisht i bazuar në gravitet me pak ose fare shpenzime për energji elektrike dhe si pasojë përfitimet financiare për reduktim të UPF janë të limituara. Megjithatë, ne jemi mëse të bindur në mendimin se a) humbjet nuk duhet të rriten nga viti në vit, dhe b) një nivel i tillë i lartë i humbjeve nuk mund të justifikohet në baza ekonomike, kur ka furnizim të pamjaftueshëm me ujë.



**Figura A - 3 Uji i pa-faturuar (sasi absolute)**

Krahasimet statistikore të UPF duhet të trajtohen me kujdes sepse ato lehtësisht mund të keqinterpretohen (sidomos nëse UPF paraqitet si përqindje e prodhimit). Megjithatë, treguesi i pranuar ndërkombëtarisht e ku UPF definohet si litra për konsumator në ditë është përdorur nga ne për të krahasuar performancën e KRU që dallojnë për nga madhësia e tyre (shih Figura A - 4). Për qëllime ilustruese vlera e UPF e shprehur si përqindje e prodhimit është e përfshirë në kllapa. Asociacioni Ndërkombëtar i Ujit 'Softveri i Bilancit të Ujit' humbjet e ujit që tejkalojnë 600 litra për kyçje në ditë (në

30m shtypje) i përshkruan si 'Përdorim jashtëzakonisht joefiçient i burimeve; janë të domosdoshme dhe me prioritet të lartë programet për reduktimin e rrjedhjeve.' Pa asnjë përjashtim, të gjitha KRU i takojnë kësaj kategorie.



**Figura A - 4 Performanca krahasuese për UPF, paraqitur si litra për konsumator për ditë (% e prodhimit)<sup>9</sup>**

Nuk është reale që në një afat të shkurtër kohor të pritët nga KRU që të reduktojnë në nivele drastike nivelin e UPF. Reduktime të konsiderueshme mund të arrihen vetëm me një kombinim të investimeve kapitale në ripërtitje infrastrukture si dhe me përmirësime në menaxhimin e rrjetit. Pavarësisht nga planifikimet e ulëta për ripërtitje infrastrukture në procesin e rishikimit tarifor 2009-2011, të cilat ne besojmë se do të kishin reduktuar UPF, shpenzimet aktuale për ripërtitjen e infrastrukturës për periudhën 2009 - 2010 nga të gjitha KRU ishin të papërfillshme. Prandaj ne nuk jemi të befashuar që UPF është rritur dhe përpos nëse KRU zotohen për planet e tyre të shpenzimeve ashtu siq janë të paraqitura në biznes planet e tyre dhe adoptojnë një qasje më strategjike për të reduktuar UPF situata veq se do të përkeqësohet.

### 3.1.2 Jo-financiare (komerciale)

Ky nën-sesion fokusohet mbi aspektet komerciale të furnizimit me ujë të tilla si mbulueshmëria me shërbime, matja dhe ankesat me fokusim në ato aspekte që kanë ndikim në konsumatorë.


#### *Mbulueshmëria me shërbime*

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të dedikuar të furnizimit me ujë<sup>10</sup>. Figura A - 5 ilustron nivelin e mbulueshmërisë me shërbime të shtatë KRU për vitet 2009 dhe 2010. Edhe pse të gjitha KRU kanë rritur mbulueshmërinë me shërbime norma e rritjes është më e ngadalshme se sa që do të duhej të ishte. Me përjashtim të KRU Radoniq (Gjakovë) (norma prej 99% e mbulueshmërisë me shërbime konsiderohet të jetë e kompletuar/e plotë), sipas normave aktuale të progresit do të duheshin deri dhjetë vjet që KRU Hidromorava (Gjilan), KRU Bifurkacioni (Ferizaj), KRU Prishtina (Prishtinë) dhe KRU Hidrodrini (Pejë) të arrinin mbulueshmëri të plotë me shërbime. Për KRU Mitrovica (Mitrovicë) dhe KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren), megjithatë, do të duhej kohë edhe më e gjatë. Ne i bëjmë thirrje KRU që të përshpejtojnë planet e tyre për zgjerimin e zonës së mbulueshmërisë me shërbime; kjo jo vetëm që është në interes të konsumatorit por duhet të shihet si e dobishme edhe për vetë KRU e kjo si rezultat i të hyrave shtesë që mund të sjellin konsumatorët e rinj. Ne sigurisht presim që aplikacionet e ardhshme tarifore të përfshijnë investimet në zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime me qëllim të përmbushjes së objektivave afatgjata të mbulueshmërisë së plotë me shërbime.

<sup>9</sup> Vlera e UPF për kyçe në ditë është përshtatur/rrregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.

<sup>10</sup> Vlerësimet e kaluara të mbulueshmërisë me shërbime ishin të bazuara në të dhënat mbi numrin e popullatës që nuk ishin plotësisht të sakta. Megjithatë në këtë raport kemi përdorur të dhëna statistikore të përdatësuar nga regjistrimi i bërë në 2011. Ne kemi supozuar se të dhënat e përdorura për popullsinë dhe ekonominë familjare që janë përdorur në 2006 në atë kohë ishin të sakta, korrekte dhe se ndryshimet vjetore që nga ajo kohë janë uniforme.

Vetëm zgjerimi i rrjetit nuk është i mjaftueshëm. Në këtë raport tashmë është treguar mungesa e kapacitetit prodhues që rezulton në furnizim jo të vazhdueshëm. Çdo zgjerim i rrjetit për konsumatorët e rinj duhet të shoqërohet me investime plotësuese në resurset dhe objektet prodhuese të ujit.



**Figura A - 5 Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë**

### Matja e ujit

Një nga rekomandimet e Kuvendit të Kosovës kërkon që të gjithë konsumatorët të kenë të instaluar ujëmatës (ujëmatës individual ose të përbashkët 'ujëmatës kolektiv'). Çdo vit KRU punojnë për të arritur këtë objektiv dhe shumica kanë arritur një normë prej 80% të mbulueshmërisë me ujëmatës (me përjashtime të KRU Mitrovicës (Mitrovicë) ku norma e mbulueshmërisë me ujëmatës është më pak se 60% dhe për KRU Bifurkacioni (Ferizaj) kjo normë është 75%). Vihet re se rritja vjetore e normës së matjes për shumicën e KRU është shumë e ulët e që kjo sugjeron se ato ndoshta janë duke arritur në atë pikë ku instalimi i mëtejshëm i ujëmatësve mund të jetë i limituar për shkak të kufizimeve/pengesave teknike, p.sh. blloqet e vjetra të apartamenteve nuk ishin të projektuara për të akomoduar/mundësuar instalimin e ujëmatësve. Ne vazhdojmë të mbështesim programin e ujëmatësve dhe kërkojmë që KRU të vazhdojnë me përpjekjet e bëra deri tani, por në të njëjtën kohë kemi parasysh edhe kufizimet teknike me të cilat ballafaqohen KRU në përmbushjen e këtij objekti. Për më tepër, ne i inkurajojmë të gjithë ndërtuesit që në planet e tyre të përfshijnë mundësinë e instalimit të ujëmatësve individual për secilën banesë.

### Ankesat

KRU mbajnë regjistra të ankesave nga të cilat ne mund të shqyrtojmë performancën. Pasi që, natyra e ankesave mund të jetë e larmishme dhe rëndësive të ndryshme, në një farë mënyre ky tregues i performancës është disi subjektiv. Pavarësisht nga subjektiviteti i këtij treguesi ne jemi në gjendje të bëjmë disa komente të përgjithshme:

- Numri i përgjithshëm i ankesave për vitin 2010 është rritur me mbi 30%<sup>11</sup> që sugjeron një pakënaqësi të përgjithshme e në rritje të konsumatorëve për performancën e KRU.
- Pjesa më e madhe e ankesave (diku rreth 75%) kanë të bëjnë me çështjet teknike dhe jo me çështjet komerciale që le të kuptohet se ekziston një pakënaqësi e përgjithshme me nivelet e shërbimit, por sa i përket çmimeve, leximit të ujëmatësve dhe aspekteve tjera komerciale tregohet një pakënaqësi më e vogël.

Këto vëzhgime përforcojnë shqetësimet tona se nivelet e shërbimit nuk janë ato që do të duhet të ishin. Shkaku kryesor i rritjes së ankesave teknike mund të jetë si pasojë e efekteve të mos balancimit në mes të kërkesës, për shkak të rritjes së bazës së konsumatorëve, dhe kapacitetit prodhues. Për më tepër, ne besojmë se është i ekzagjeruar perceptimi i mundësisë së kufizuar për të paguar pasi që ka

<sup>11</sup> Krahasuar me vitin 2009 kur ankesat teknike ishin 7,200 dhe ato komerciale ishin 2,257, në vitin 2010 ka një shtim të ankesave në 9,166 ankesa teknike dhe 3,338 komerciale

shumë të ngjarë që konsumatorët do të ishin të gatshëm të pranojnë çmime më të larta në këmbim të shërbimeve të përmirësuara. Ne nuk jemi dakord me konceptin e uljes së çmimeve mbi arsyetimin e pastudiuar të mundësive të kufizuara për pagesë, veçanërisht në qoftë se një veprim i tillë do të rezultonte me rënie të niveleve të shërbimit (ose mos përmirësim të tyre).

### 3.1.3 Financiare


Ky nën-sesion fokusohet në aspektet financiare të furnizimit me ujë të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

**E rëndësishme:** Të gjitha vlerat financiare të shprehura në euro janë rregulluar/përshtatur në bazë të çmimeve të mesit të vitit 2010 e kjo për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.

#### Shitjet

##### Volumi i ujit të shitur

Volumi i ujit të shitur në vetvete nuk është një tregues i performancës, por më tepër paraqet se sa ujë është shitur në raport me shitjet e planifikuara. Figura A - 6 paraqet performancën e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siq ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor 2009-2011.




**Figura A - 6 Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifor 2009-2011**

Duke patur parasysh se aplikacionet janë përgatitur në 2008 është e vështirë për të kuptuar se si shitjet e planifikuara (me përjashtim të KRU Hidrodrini (Peja)) për vitin 2009 mund të jenë caq të ndryshme në raport me shitjet aktuale. Një pjesë e nën-performancës së shitjeve mund t'i atribuohet një rritjeje të UPF, e cila, kur fabrikat e prodhimit janë duke operuar me kapacitet maksimal, do të rezultojë në kufizime të furnizimit. Ngjashëm, dështimi për të zgjeruar bazën e konsumatorëve do të kontribuojë gjithashtu në nën-performancë të shitjeve. Megjithatë, këta faktorë pritet që të kenë vetëm një ndikim marginal në shitjet aktuale në raport me shitjet e planifikuara. Megjithatë analiza e aplikacioneve tarifore tregon një dështim fundamental e kjo sepse të dhënat bazë të shitjeve volumetrike të përdorura në aplikacionet tarifore ishin thelbësisht të ndryshme krahasuar me volumet e shitjeve faktike (të raportuara në ZRRUM) duke ngritur shqetësime serioze në lidhje me aftësitë planifikuese në disa KRU. Ndikimi më i madh i mbi vlerësimeve të tilla të volumeve të shitjeve, është se tarifat e përcaktuara në shqyrtimin e fundit kanë qenë dukshëm më të ulëta se sa që ato do të ishin nëse projeksionet e shitjeve do të ishin më të sakta. Ndikimet konsekuente janë të ardhurat e pamjaftueshme nga shitjet për të përmbushur nevojat financiare të KRU, në veçanti për financimin e mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes infrastrukturore. Rëndësia e një plani të menduar mirë dhe projeksionet e sakta nga KRU në aplikacionet e ardhshme tarifore nuk duhet të jenë të ekzagjeruara.



### Vlera e shitjeve (EUR)

Pa ndonjë befasi, vlera e shitjeve për çdo KRU ishte shumë më e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve (shih Figura A - 7), kryesisht për shkak të parashikimeve të dobëta të volumeve të shitjeve siç është përshkruar më sipër. Përveç kësaj, vlera e shitjeve u reduktua në terma real për shkak se ZRRUM nuk bëri rregullimin e duhur të inflacionit vjetor në tarifa siq kërkohet në procesin e rishikimit tarifor 2009-2011<sup>12</sup>, qëllimi i ZRRUM ishte penalizimi i KRU për mos përmbushjen e objektivave të tyre të investimeve.



**Figura A - 7 Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara të përcaktuara në rishikimin tarifor 2009-2011**

Ky nën-vlerësim substancial i volumit të shitjeve dhe vlerave të shitjeve i ka goditur plotësisht KRU sa i përket burimeve financiare që do të ishin të nevojshme për të përmbushur planet e tyre të investimeve. Pavarësisht këtij dështimi për të përmbushur caqet e shitjeve vlera absolute e shitjeve është rritur, kjo kryesisht i atribuohet rritjes së tarifave në mes 2009 dhe 2010.

### ***Kostot për njësi***

#### Prodhimi

Ka qenë e mundur që të ndërmerret një vlerësim i përafërt i kostos për njësi të prodhimit të ujit<sup>13</sup>. Kostot e prodhimit të ujit variojnë nga EUR 0.025/m<sup>3</sup> (KRU Hidrodrini (Pejë)) në EUR 0.063/m<sup>3</sup> (KUR Hidroregjioni Jugor (Prizren)). Edhe pse këto kosto për njësi shfaqen të vogla në krahasim me tarifën mesatare duhet pasur parasysh nivelin e lartë të humbjeve së bashku me efikasitetin dhe të ardhurave, përafërsisht duhen rreth 4 m<sup>3</sup> të ujit të prodhuar për të gjeneruar 1 m<sup>3</sup> të ujit të shitur dhe të paguar për të. Si pasojë, kostoja reale e prodhimit të ujit për m<sup>3</sup> të ujit të shitur dhe të paguar për të është prej EUR 0,10 deri në EUR 0,25.

Në terma reale kostoja e prodhimit të ujit ka shënuar një rënie marginale nga 2009 në 2010.


Sipas kontabilitetit rregullator të vlerësimit të aseteve fikse dhe provizionimeve të zhvlerësimit të tyre ka shumë pak dallim në mes të shpenzimeve operative dhe koston së plotë të prodhimit të ujit.

<sup>12</sup> Tarifët për vitin 2009 dhe 2010 ishin të përcaktuara sipas niveleve të çmimeve të mesit të vitit 2008. Tarifa për vitin 2009 duhej të ishte tarifa e përcaktuar e rregulluar sipas inflacionit në periudhën Tetor 2007-Tetor 2008. Kjo do të rezultonte me një ngritje prej 4.5% të tarifës ashtu siç është përcaktuar në 2008. Në mënyrë të ngjashme, për vitin 2010, tarifët duhet të ishin rregulluar për 2.8% (kombinim i 4.5% dhe inflacionit negativ (deflacionit) prej 1.7% në 2009) për tarifën e vitit 2010 siq ishte përcaktuar në vitin 2008.

<sup>13</sup> Vlerësimi është bërë me ndarjen e shpenzimeve operative në mes prodhimit, distribuimit dhe aktiviteteve biznesore duke u bazuar kryesisht në punën e ndërmarrë nga ZRRUM në zhvillimin e llogarive rregullatore si dhe në një shkallë të gjykimit profesional. Rezultatet janë shumë larg precizitetit por me kalimin e kohës, e me futjen në përdorim të llogarive rregullatore analizimi i kostove për njësi do të jetë shumë më preciz.


### Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujë

Kostoja totale për njësi për aktivitetet e furnizimit me ujë (kostot operative plus mirëmbajtja kapitale, por duke përfshirë kthimin në kapital dhe borxhet e këqija<sup>14</sup>), të përshtatura me nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2010, është paraqitur në Figura A - 8.



**Figura A - 8 Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (duke përfshirë kthimin në kapital dhe borxhet e këqija)**

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2009-2011 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2010) në shumicën e rasteve ishin më të larta se ato aktuale (shih Figura A - 9). Megjithatë, kjo nuk tregon efikasitet më të madhe se sa ishte planifikuar për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritje infrastrukturore dhe zhvlerësim sipas kostos aktuale për asetet e reja, e që asnjëra nuk ka ndodhur (shih nën-sesionin në vijim). Kjo efikasitet dukshëm e përmirësuar për KRU në fakt ka ndodhur për shkak të kufizimeve të tyre në raport me qarkullimin e parasë së gatshme (arkëtim i dobët i të ardhurave), duke i kufizuar ato në ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme të mirëmbajtjes kapitale, e në veçanti ripërtëritjeve infrastrukturore. Ajo se çfarë nënkutohet me këtë është se edhe pse kostot për njësi në përgjithësi ishin më të ulëta se sa ishin planifikuar kjo rezultoi me përkeqësimin e gjendjes së aseteve dhe rënien e nivelit të shërbimeve.




**Figura A - 9 Kostoja për njësi të furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi**

<sup>14</sup>Në përputhje me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit borxhet e këqija në këtë raport janë të definuara si shuma e të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak

## Shpenzimet kapitale

Procesi i rishikimit tarifor 2009 - 2011 kishte përfshirë provizionime për shpenzime kapitale si për mirëmbajtje kapitale poashtu edhe për rritje kapitale. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve, sidomos e atyre për mirëmbajtje kapitale, pritej se do të financohej nga burimet e veta financiare të KRU dhe për këtë arsye është përfshirë në tarifa. Ne jemi të zhgënjyer kur shohim se shpenzime aktuale kapitale të ndërmarra nga KRU në dy vitet e fundit janë të papërfillshme në krahasim me atë që ishte planifikuar (shih Figura A - 10). Ne e pranojmë se ende nuk është e mundur që saktësisht të bëhet dallimi në mes të shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale dhe shpenzimeve për rritje kapitale, por hetimet tona na bëjnë të besojmë se pothuajse të gjitha shpenzimet kapitale kanë qenë të dedikuara në zgjerimin kapital me pak ose aspak shpenzime për mirëmbajtje kapitale, fakt i cili rezulton me përkeqësim të bazës së asetëve dhe rënie të niveleve të shërbimit. Rritja e UPF, është dëshmi për këtë dështim në ndërmarrjen e aktiviteteve efektive të mirëmbajtjes kapitale brenda rrjetit.



**Figura A - 10 Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara (sipas niveleve të çmimeve të mesit të vitit 2010)**

Vihet re se shumica e niveleve të larta të investimeve të deklaruara nga KRU Hidromorava (Gjilan) dhe KRU Hidrodriini (Peja) ishin nga financimet e agjencive zhvillimore se sa që ishin të financuara nga burimet vetanake financiare. Shkaku kryesor i këtij dështimi për të përmbushur objektivat e investimeve ishte për shkak të nën-performancës komerciale; arkëtimi i të ardhurave ishte dukshëm më i ulët se çfarë ishte planifikuar dhe kur kjo kombinohet me shitjet më të ulëta se ato të planifikuara para ja pritshme e gatshme në disponim për investime praktikisht mungonte. Ne presim që parashikimet për të ardhmen të jenë dukshëm më të sakta dhe si rezultat ne presim që planet e investimeve të realizohen ashtu siç edhe dorëzohen në aplikacionet për rishikimin e ardhshëm tarifor.

## 3.2 Shërbimet për ujërat e zeza

Ky nën-seksion analizon performancën e shtatë KRU në lidhje me shërbimet për ujërat e zeza në vitin 2010 dhe e krahason performancën e vitit 2010 me atë të viteve të mëparshme si dhe kundrejt caqeve / pritjeve që janë të përfshira në rishikimin tarifor 2009-2011. Sikurse për furnizimin me ujë ne nën-ndajmë këtë analizë në tre sesione kryesore: jo-financiare (teknike), jo-financiare (komerciale) dhe financiare.

### 3.2.1 Jo-financiare (teknike)

Ky nën-sesion fokusohet në aspektet teknike të shërbimeve për ujërat e zeza të tilla si: cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara, nivelet e shërbimit etj., me një fokusim në ato aspekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shërbimet ofruar konsumatorëve.

## **Standardet e shërbimit**

### **Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara**

Pasi që nuk ka impiante funksionale për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë është e logjikshme të supozohet se të gjitha ujërat e zeza të shkarkuara nuk arrijnë t'i përmbushin standardet e mbrojtjes së mjedisit<sup>15</sup>. Për më tepër, nuk ka gjasa që trajtimi i ujërave të zeza të jetë funksional edhe për shumë vite e për këtë arsye matja e cilësisë së ujërave të zeza të shkarkuara mbi bazën e përqindjes së testeve të kaluara do të ishte e pakuptimtë. Në vitet e ardhshme si një alternativë për monitorimin e cilësisë ne duhet të masim cilësinë në bazë të përqindjes së konsumatorëve shtëpiak që u ofrohen jo vetëm shërbime të grumbullimit të ujërave të zeza por poashtu edhe shërbime të trajtimit të tyre.

### **Besueshmëria dhe shërbyeshmëria**

Matja kryesore e besueshmërisë së grumbullimit të ujërave të zeza është përmes vërshimeve në kanalizim (ose bllokimet) dhe për qëllime krahasuese kjo matje zakonisht bëhet mbi bazën e bllokimeve për 100 km të gypave në vit. Rezultatet e raportuara tregojnë ndryshime të performancave nga 186 bllokime për 100 km të gypave (KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)) deri në 886 bllokime (KRU Bifurkacioni (Ferizaj)), me një mesatare (të ponderuar) prej 568. Në nivel ndërkombëtar nuk ka pikë referimi që tregon një performancë të kënaqshme, por sipas hulumtimeve tona paraprake arrihet në konkludim se një rrjet mirë funksionues i kanalizimeve nuk duhet të ketë më shumë se 100 bllokime / vërshime për 100 km të gypave në vit. Ne ende nuk kemi ndonjë informatë mbështetëse në lidhje me shkaqet e një niveli kaq të lartë të bllokimeve por mund të supozojmë se neglizhenca afatgjate e mirëmbajtjes së nevojshme kapitale nuk ka ndihmuar e ku funksionimi kryesor i personelit operativ për shërbimet e ujërave të zeza është i një qasjeje reaguese (zhbllokimi i kanalizimeve etj.) në vend se të jenë pro-aktiv (rilinjëzimi i kanalizimeve, riparimet etj.).

Shërbyeshmëria e sistemit për grumbullimin e ujërave të zeza matet sipas numrit të dështimeve (kolapseve) për 100 km gyp për vit. Sikurse me vërshimet e kanalizimeve norma është jashtëzakonisht e lartë me një normë mesatare prej 330 riparimeve të nevojshme për 100 km gyp. Përsëri, shkaku kryesor nuk mund të identifikohet në këtë fazë por është e arsyeshme të supozohet se sistemet janë të vjetra dhe se nuk kishte ose kishte fare pak investime në mirëmbajtje kapitale, me kalimin e viteve pritet që të ketë normë edhe më të lartë të dështimeve (kolapseve).

Për të përmirësuar si besueshmërinë e poashtu edhe shërbyeshmërinë ne presim që KRU, në aplikacionet e tyre të ardhshme tarifore, të përfshijnë provizionime të konsiderueshme për rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjeteve të ujërave të zeza.

## **3.2.2 Jo-financiare (komerciale)**

Ky nën-sesion fokusohet në aspektet komerciale të ujërave të zeza të tilla si: mbulueshmëria me shërbime dhe ankesat me fokusim në ato aspekte që ndikojnë drejtpërdrejtë në konsumatorë.

### **Mbulueshmëria me shërbime**

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza definohet si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që janë të kyçur në rrjetin e ujërave të zeza. Për dallim nga furnizimi me ujë caku i mbulueshmërisë nuk është domosdoshmërisht 100%, pasi që shumë prona në zonat rurale mund të jenë në lokacione shumë të largëta nga rrjeti e në të cilin rast gropat septike janë më të përshtatshme. Caku i mbulueshmërisë prej 95% do të ishte më i pritshëm por kjo duhet të jetë subjekt i analizimit të mëtejshëm nga KRU.

---

<sup>15</sup> Për qëllime të përgjithshme të performancës në lidhje me cilësinë e ujërave të zeza të shkarkuara supozohet se të gjitha KRU poentohen me zero pikë në lidhje me pajtueshmërinë me standardet mjedisore.

### Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të zeza




Figura A - 11 Mbulueshmëria me shërbimet e ujëra të zeza

Normat e mbulueshmërisë të paraqitura në Figura A - 11 sugjerojnë se ka pasur rritje shumë të limituar të mbulueshmërisë me shërbime nga 2009 në 2010<sup>16</sup>. Një zvogëlim i tillë i mbulueshmërisë mund të shpjegohet nga rritja e numrit të ekonomive familjare që nuk ka rezultuar me një rritje korresponduese në numrin e kyçjeve. Këto nivele janë shumë më të ulëta se normat e mbulueshmërisë për standardet mjedisore të Evropës dhe nëse Kosova do që të përmbush aspiratat në përputhje me standardet e BE janë të domosdoshme investime të konsiderueshme në zgjerimin e rrjetit të ujërave të zeza dhe ne presim që në aplikacionet e ardhshme tarifore të përfshihet elementi i rëndësishëm për shpenzimet e rritjes së rrjetit të ujërave të zeza. Megjithatë ne e vlerësojmë, se investimet e tilla janë të kushtueshme dhe niveli i investimeve të kërkuara nuk mund të ndërmerret pa mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar për zhvillim.

#### Ankesat

Ankesat specifike për sektorin e ujërave të zeza nuk janë të identifikueshme. Referojuni sesionit 3.1.2.

### 3.2.3 Financiare


Ky nën-sesion fokusohet në aspektet financiare të shërbimeve të kanalizimit të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

**E rëndësishme:** Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujë të gjitha vlerat e shprehura në euro janë të rregulluar sipas çmimeve bazë të mesit të vitit 2010 për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.

#### Shitjet

Vlera e shitjeve për shërbimet e ujërave të zeza drejtpërdrejt është e lidhur me volumet e shitjeve të ujit. Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara vlera e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të zeza gjithashtu është nën vlerat e planifikuara të shitjeve (shih Figura A - 12).

<sup>16</sup> Shkalla e mbulueshmërisë është shtrembëruara pasi ajo është e përcaktuar në bazë të numrit mesatar të kyçjeve në vit. Të dhënat për mbulueshmërinë në fund të vitit 2008 janë më të larta se në 2009, fakt i cili lë të kuptohet se të dhënat e fundit të vitit 2008 (sipas të cilave është llogaritur mesatarja e vitit 2009) mund të jenë të pasakta.




**Figura A - 12** Shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me shitjet e planifikuara sipas rishikimit tarifor 2009-2011

Pavarësisht se nuk janë arritur caqet e shitjeve, të ardhurat nga shitjet për shërbimet e ujërave të zeza në terma real aktualisht janë rritur për 4% edhe pse kryesisht kjo ishte për shkak të ngritjes së tarifave se sa për shkak të performancës së përmirësuar komerciale.

### *Kostot për njësi*

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza janë të definuara si kosto vjetore për konsumatorët shtëpiak të shërbyer<sup>17</sup>. Kostot për njësi për vitin 2009 dhe 2010 janë të paraqitura në Figura A - 13. Këto kosto për njësi janë shumë të ulëta në krahasim me kostot e shërbimeve të ujërave të zeza në shumë prej ekonomive të tjera perëndimore, kryesisht për shkak të faktit se nuk ka shpenzime të trajtimit. Për më tepër, duke mos investuar në mirëmbajtje kapitale në rrjet në periudhën raportuese këto shpenzime janë më të ulëta se sa që ato do të duhej të ishin.



**Figura A - 13** Kostoja për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza (duke përfshirë kthimin në kapital dhe borxhet e këqija)

Ne kemi parasysh nevojën për përmirësimin e konsiderueshëm të shërbimeve të ujërave të zeza në Kosovë, sidomos futjen në përdorim të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza si dhe zgjerimin e rrjetit. Megjithatë këto aktivitete, në masë të madhe shtojnë koston e shërbimeve të ujërave të zeza dhe në terma afatgjatë mund të rezultojë që kostot e shërbimeve të ujërave të zeza do të rriten aq shumë

<sup>17</sup> Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohej si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo-shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

sa që do të tejkalojnë kostot e shërbimeve të furnizimit me ujë. Aktualisht kostoja vjetore për shërbimet e ujërave të zeza që i ngarkohet një konsumatori shtëpiak është më e vogël se 1/10 e kostove të furnizimit me ujë.

### Shpenzimet kapitale

Sikurse për furnizimin me ujë rishikimi tarifor 2009-2011 ka përfshirë provizionime të konsiderueshme për mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur. Përpos KRU Mitrovica (Mitrovicë) dhe KRU Hidromorava (Gjilan), ku ka pasur kontribute të konsiderueshme të financuara nga grantet e agjencive ndërkombëtare për zhvillim, shpenzimet kapitale të KRU për shërbimet e ujërave të zeza ishin afërsisht 2% e nivelit që ishte planifikuar gjatë procesit të rishikimit tarifor. Sikurse për furnizimin me ujë ne presim plane për të ardhmen të cilat do të sigurojnë investime adekuata në sektorin e ujërave të zeza për të siguruar nivele të kënaqshme të shërbimit, përmirësim të mbulueshmërisë me shërbime dhe, në terma afatgjatë, trajtim të ujërave të zeza. Posa këto plane të investimeve të përfshihen në rishikimin e ardhshëm tarifor 2012-2014 ne presim që të njëjtat të implementohen.

## 3.3 Performanca e KRU - Financiare

### 3.3.1 Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave

Siç u përmend më herët në këtë raport, performanca e shitjeve të KRU si për 2009 e pashtu edhe për 2010 kanë qenë larg arritjes se cakeqe të parapara. Shitjet e kombinuara (ujë dhe ujëra të zeza) në krahasim me ato të planifikuara janë të ngjashme me atë të furnizimit me ujë (Figura A - 7). Megjithatë duke e konsideruar këtë problem si një të tërë, nën-performanca në arkëtimin e parasë së gatshme është e konsiderueshme (shih Figura A - 14).




Figura A - 14 Efiçienca në arkëtimin e të ardhurave<sup>18</sup>

Performanca e arkëtimin të të ardhurave për të shtatë KRU ishte më e ulët se parashikimet/pritjet. Ne nuk pajtohemi me pohimet e bëra nga KRU se rezistenca për të paguar kryesisht është për shkak të kufizimeve të përballeshmërisë së pagesës-sidomos nga 'rastet sociale' të regjistruara. Hulumtimet e bëra në vitin 2007 nga ana e ZRRUM si dhe nga ana e konsulentëve tregon se edhe në rastin më të keq, ne presim që vetëm 8% e konsumatorëve mund të kenë vështirësi për të paguar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza. Ne besojmë se problemi është motivimi i menaxhmentit dhe jo përballeshmëria. Ne gjithashtu besojmë se nuk ka të ngjarë se do të ketë përmirësime të dukshme në arkëtimin e të ardhurave pa përdorimin/vënien në funksion të stimujve financiar për menaxhmentin dhe personelin. ZRRUM ka paraqitur propozime të thjeshta për Qeverinë e

<sup>18</sup> Llogaritja e efiçencës në arkëtimin e të ardhurave është ndryshuar për të përfshirë të ardhurat e marra për taksat e kyçjes si dhe të ardhurat tjera pasi që këto janë parapagime dhe nuk ka rrezik të mos pagesës së tyre.

Kosovës dhe vetë KRU për krijimin e mekanizmit **vetë-financues** stimulues për të gjithë personelin e KRU në mënyrë që të përmirësohet arkëtimi i të ardhurave por kjo ende ngelet për t'u aprovuar dhe adoptuar.

Figura A - 15 ilustron ndikimin e përgjithshëm të kombinuar për dështimin e arritjes së caqeve të shitjes me dështimin për të arritur caqet e arkëtimit (të dhënat vetëm për 2010). Në rastin më ekstrem, arkëtimi i përgjithshëm i të ardhurave për shtatë KRU arrin në vetëm 50% të shitjeve të planifikuara<sup>19</sup>, një nivel i performancës që është më pak se i kënaqshëm.




Figura A - 15 Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave në raport me planifikimin (2010)

### 3.3.2 Kthimi në kapital

Përmes rishikimit tarifor 2009 - 2011 u fut në përdorim koncepti që KRU të fitojnë kthimin në kapital, si kusht i domosdoshëm për të arritur një nivel huamarrës të mjaftueshëm për të tërhequr investimet shumë të nevojshme në këtë sektor. Për rishikimin tarifor 2009-2011 kemi propozuar një vlerë të vërtetë të kthimit (pas inflacionit) prej 4% në bazën rregullatore të aseteve (BRA)<sup>20</sup>. Pa ndonjë befasi, kthimet aktuale janë dukshëm nën këtë normë dhe në shumicën e rasteve janë negative (shih Figura A - 16). Edhe pse KRU Bifurkacioni (Ferizaj), KRU Prishtina (Prishtinë) dhe KRU Hidrodrini (Pejë) kanë arritur kthime pozitive në 2010 e të cilat nuk ishin shumë më të ulëta se kthimi i planifikuar kjo jo domosdoshërisht do të thotë se ato kishin performancë të mirë por se ato arritën të mbajnë shpenzimet e tyre (duke përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale në BRA) brenda kufijve të të ardhurave të tyre. Sikur këto kompani të kishin zbatuar aktivitetet e tyre për ripërtëritjen infrastrukturore siç ishte e përcaktuar në planet e tyre këto kthime do të reduktoheshin ndjeshëm ose mbase edhe do të eliminoheshin në tërësi.

<sup>19</sup> Një pjesë shumë e vogël (pothuajse e papërfillshme) e dështimit për të arritur caqet e të ardhurave i atribuohet faktit që KRU nuk i është bërë përshtatja prej 2.8% e inflacionit për tarifa, që kërkohet nga metoda e përcaktimit e aplikuar gjatë rishikimit tarifor.

<sup>20</sup> Për detaje të mëtejshme mbi bazën rregullatore të aseteve (se si është e definuar dhe e përcaktuar, etj.) referojuni Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit të ZRRUM.






Figura A - 16 Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve (BRA)

## 3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

### 3.4.1 Arsyeshmëria

Në raportet e kaluara të performancës vjetore ne kemi matur performancën e përgjithshme krahasuese në mes KRU. Në këtë raport të performancës për vitin 2010 e kemi ndryshuar ndjeshëm arsyeshmërinë e matjes së performancës së përgjithshme e ku performanca matet kundrejt një niveli ideal të performancës. Ne e kemi vlerësuar performancën e përgjithshme për çdo sektor (furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza) mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë dhe efikasitetit të kostos. Këto pastaj janë kombinuar dhe i është shtuar efikasiteti komercial dhe financiar (arkëtimi i të ardhurave dhe kthimi në BRA) për të arritur në një matje të përgjithshme të performancës së KRU. Të gjitha matjet e performancës janë të shprehura si përqindje e ku idealja është 100%.

SHTOJCA 2 ofron një shpjegim të detajuar të arsyeshmërisë së përdorur.

### 3.4.2 Vlerësimi i performancës

#### *Shërbimet e furnizimit me ujë*

Figura A - 17 paraqet matjen e performancës së përgjithshme të shtatë KRU në bazë të kësaj metodologjie të re të përdorur. Rezultatet duhet të trajtohen me kujdes pasi që disa KRU nuk kanë ofruar të dhëna të plota dhe për këtë arsye u është dhënë rangimi prej zero pikësh për ato të dhëna që nuk kanë qenë të plotë<sup>21</sup>. Për shembull, performanca e KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren) në fakt mund të jetë dukshëm më e mirë se sa që është paraqitur këtu nëse të dhënat e kërkuara nga ZRRUM do të ishin dhënë në disponim për analizë. Për raportet e ardhshme ne presim të dhëna më të plota dhe, kur është e nevojshme, mund të kërkojë të dhëna të ndryshuara për vitet e mëparshme.

<sup>21</sup> KRU Prishtina (Prishtinë), KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren), KRU Mitrovica (Mitrovicë) dhe KRU Radoniqi (Gjakovë) nuk kanë ofruar të dhëna për disponueshmërinë për vitin 2009, dhe KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren), nuk ka ofruar të dhëna për disponueshmërinë për 2010. KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren), dhe KRU Mitrovica (Mitrovica) nuk kanë ofruar të dhëna për shtypjen as për vitin 2009 e as për vitin 2010.

### Performanca e përgjithshme për Furnizimin me ujë




Figura A - 17 Vlerësimi i përgjithshëm i performancës për furnizimin me ujë (2009 & 2010)

Është për t'u vënë re se performanca e KRU Prishtina (Prishtinë) është pranë ideale për në shumicën e treguesve me përjashtim të dështimit kryesor për të ofruar furnizim 24 orë për shumicën dërmuese të konsumatorëve. Programi aktual i investimeve është i projektuar për të kapërcyer këtë pengesë të madhe të performancës. Pasi që punët të jenë komisionuar ne presim që performanca nga KRU Prishtina (Prishtinë) të avancojë dukshëm pranë nivelit ideal të performancës.

Për shkak të dorëzimit jo të plotë të të dhënave në përputhje me këtë arsyeshmëri për vitin 2009 nuk është e mundur që saktësisht të konstatohet nëse performanca është duke u përmirësuar ose jo, e kjo vlen si për KRU individuale e poashtu edhe për sektorin e ujit në tërësi. Po ashtu nuk është e mundur të identifikohet KRU me përmirësimin më të kënaqshëm. Raporti i performancës për vitin e ardhshëm do të prodhojë vlerësim shumë më të saktë të performancës si dhe do të tregojë shkallën e përmirësimit të performancës (ose përkeqësimit) që nga 2010.

### Shërbimet për ujërat e zeza

Figura A - 18 ilustron performancën e përgjithshme të KRU në lidhje me shërbimet e ujërave të zeza. Është e qartë se pa impiante për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë të gjitha KRU do të shënojnë pikë jo të favorshme në raport me ofruesin ideal të shërbimeve. Në mënyrë të ngjashme, pasi që besueshmëria për të gjitha KRU (e matur mbi bazen e vërshimeve / bllokimeve për 100 km gyp në vit) është më e lartë se maksimalja absolute prej 100, të gjitha KRU do të marrin zero pikë për këtë parametër.

### Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza




Figura A - 18 Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza (2009 & 2010)

Diagrami i performancës ilustron nevojën për investime të konsiderueshme në përmirësimin e objekteve të ujërave të zeza, duke përfshirë: zhvillimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza si dhe objekteve përcjellëse të hedhjes së llumit; zgjerimin në shkallë të madhe të sistemit dhe rehabilitimin, në mënyrë që të përmirësohet besueshmëria e saj, e pa të cilat masa do të ishte e pamundur për KRU që të arrijnë përmirësim të prekshme në ofrimin e shërbimeve të ujërave të zeza.

### Performanca e përgjithshme e kombinuar

Figura A - 19 bashkon performancën e dy sektorëve të biznesit atë të furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza e poashtu edhe të aspekteve më të gjëra komerciale të profitabilitetit dhe performancës në arkëtimin e të ardhurave.

### Performanca e përgjithshme e KRU




Figura A - 19 Performanca e përgjithshme e KRU (2009 & 2010)

Shihet qartë se, pa asnjë përjashtim, KRU janë duke operuar në nivele edhe më të ulëta se çfarë do të konsiderohej një nivel minimal, le të themi, 80% e ideale. Dihet se aryseja kryesore që ndikon në performancën e përgjithshme janë shërbimet e ujërave të zeza, dhe mungesa e trajtimit dhe në veçanti mbulueshmëria e dobët me shërbime. Ne poashtu kemi parasysh se për shumicën nga përmirësimet e nevojshme (për të dy aktivitetet biznesore) kërkohen nivele të konsiderueshme të investimeve. Megjithatë për të siguruar investime të tilla, KRU duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre për të maksimizuar eficientësinë në ato zona që ato janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të tyre, në veçanti në eficientësinë e arkëtimit të të ardhurave dhe eficientësinë operative.

ZRRUM ka një rol të madh në sigurimin që tarifat e përcaktuara në rishikimin e ardhshëm tarifor të jenë të mjaftueshme për të financuar planet e investimeve të nevojshme për KRU për të arritur nivelin e tyre të objektivave të shërbimit dhe për të siguruar që KRU në të vërtetë ndërmarrin aktivitetet e investimeve të lejuara gjatë rishikimit të tarifave. Megjithatë, nevoja për të kufizuar rritjen e tarifave gjatë periudhës 2012-2014 për brenda kufizimeve të përballueshmërisë së pagesës në Kosovë mund të detyrojë ZRRUM që të vendosë kufizime mbi shumën e shpenzimeve kapitale gjatë periudhës së rishikimit tarifor 2012 - 2014.

## 4 PERFORMANCA E SEKTORIT

Ky është Raporti i pestë Vjetor i Performancës i hartuar nga ZRRUM. Mendojmë se është e përshtatshme që të shqyrtohet performanca e sektorëve si një tërësi gjatë kësaj periudhe me fokusim në prodhim, shitje, mbulueshmëri, qarkullim, investime etj. Ky sesion i raportit paraqet një pasqyrë të shkurtër të performancës në raport me planet, në rastet kur ka të dhëna në dispozicion. Ne sugjerojmë kujdes në interpretimin e rezultateve të kësaj analize pasi që ne dyshojmë për një shkallë të gabimeve në rezultate, sidomos në vitet e para të analizuara ku menaxhimi i të dhënave brenda KRU ishte shumë më pak i besueshëm se sa që është sot.

Duke ditur se KRU Prishtina (Prishtinë) është kompani shumë më e madhe në raport me KRU tjera, do të thotë se statistikat e sektorit janë shumë të varura nga performanca e KRU Prishtina (Prishtinë). Prandaj, konkluzionet e përgjithshme të nxjerra në këtë sesion nuk mund të jenë të aplikueshme për të gjitha KRU.

### 4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF

Figura A - 20 paraqet ujin e prodhuar dhe të shitur gjatë pesë viteve të fundit, diferenca është e definuar si uji i pa-faturuar.




Figura A - 20 Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Analiza e këtij ilustrimi tregon se gjatë kësaj periudhe shitjet janë pothuajse të pandryshuara pavarësisht një rritjeje prej 15% të numrit të konsumatorëve. Duket se zgjerimi i bazës së konsumatorëve nuk kontribuon në rritjen e të ardhurave por faktikisht bëhet shpërndarja e vëllimit të njëjtë të ujit në një bazë më të madhe të konsumatorëve e që rezulton në efekte të kërkesës së kufizuar, e që rrjedhimisht shkakton racionalizim dhe ndërprerje të furnizimit. Prandaj është e domosdoshme që KRU të investojnë në zgjerimin e impianteve të prodhimit dhe të ulin nivelet e ujit të pa-faturuar paralelisht me programet për zgjerimin e rrjeteve pa të cilat programe nuk do të realizonin asnjë përfitim financiar.

Shihet gjithashtu se përpjekjet e KRU për të reduktuar UPF kanë qenë, mesatarisht, të dështuara. Megjithatë ne vlerësojmë se reduktimet e rrjedhjeve në një shkallë më të madhe në Kosovë ka pak gjasa që të arrihen pa investime të konsiderueshme në renovimin e sistemit. Mungesa e shpenzimeve të KRU për ripërtëritjen infrastrukturore na bënë të besojmë se KRU ripërtëritjet infrastrukturore nuk i konsiderojnë si aktivitete të prioritetit të lartë pavarësisht dështimeve në rritje që provojnë të kundërtën.

Edhe pa investime kapitale të një shkalle të madhe KRU duhet të jetë në gjendje të ndërmarrin me kosto minimale disa aktivitete për reduktimin e UPF, p.sh. zbulimin e rrjedhjeve aktive dhe zvogëlimin e shtypjes etj. Ne i nxitim KRU që të bëjnë shumë më tepër se sa ato janë duke bërë për momentin sa i

përket reduktimit të UPF dhe në këtë mënyrë të rrisin të ardhurat nga shitjet në ato zona që vuajnë nga tkurrja e kërkesës.

## 4.2 Mbulueshmëria me shërbime

Trendet e rritjes së mbulueshmërisë për të dy aktivitetet biznesore janë të ilustruara në Figura A - 21 më poshtë. Me nivelin aktual të progresit mbulueshmëria pothuajse e plotë me shërbime të furnizimit me ujë mund të arrihet në më pak se dhjetë vite. Normat e mbulueshmërisë me shërbimet e ujërave të zeza (të dhëna të detajuara ekzistojnë vetëm duke filluar nga 2009) duket se janë duke shënuar rënie. Siç e kemi thënë edhe më herët ka nevojë të madhe për të zgjeruar rrjetet e ujërave të zeza dhe zhvillimin e impianteve moderne për trajtimin e ujërave të zeza si dhe objekteve për shkarkimin e llumit.




Figura A - 21 Mbulueshmëria me shërbime

## 4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Performanca e shitjeve të sektorit (rregulluar për nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2010) është paraqitur në Figura A - 22.




Figura A - 22 Performanca financiare e sektorit (nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2010)

Është evidente se të ardhurat reale fare pak janë përmirësuar gjatë pesë viteve prej se ne raportojmë performancën. Për më tepër, në terma absolut paratë e gatshme të arkëtuara janë përmirësuar vetëm me më pak se 3.5% në vit (vjektorizuar përgjatë 5 viteve), që ka më shumë gjasa që t'i atribuohet ngritjeve reale të tarifave se sa përpjekjeve për të përmirësuar arkëtimin e të ardhurave. KRU

duhet të bëjnë shumë më tepër për të përmirësuar arkëtimin e të ardhurave dhe të përqëndrohen në sasi absolute në vend se në përqindje<sup>22</sup>.

Çfarë është gjithashtu e dukshme nga kjo analizë është bruto nën-vlerësimi i shitjeve të performancës në arkëtimin e të ardhurave në aplikacionet tarifore të KRU. Ne i bëjmë thirrje KRU që në biznes planet e tyre, pjesë e aplikacioneve tarifore për rishikimin tarifor 2012-2014, të paraqesin caqe realiste, por megjithatë sfiduese në lidhje me përmirësimet e arkëtimit të të ardhurave.

#### 4.4 Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale)

Shpenzimet kapitale në këtë sektor kanë qenë jo adekuate gjatë pesë viteve të fundit, me vetëm nivele materiale (prapë se prapë të ulëta) të shpenzimeve që janë financuar nga grante të agjencive zhvillimore dhe jo nga burimet vetanake të KRU, pavarësisht nga provizionimet në shqyrtimin tarifor 2009-2011 për të mbuluar kostot e tarifave. Nga një program kapital i planifikuar në vlerë prej EUR 94 milion për periudhën 2009 deri 2010 (përafërsisht me një ndarje prej 2/3 për furnizim me ujë dhe 1/3 për ujëra të zeza) vetëm më pak se EUR 8 milion janë implementuar (nga e cila shumë EUR 7 milion janë për ujë dhe përafërsisht EUR 0.5 milion për ujëra të zeza). Për më tepër, hulumtimet tona tregojnë se pjesa më e madhe e këtij investimi ka qenë për zgjerimin e sistemit dhe praktikisht asgjë nuk është shpenzuar në mirëmbajtje kapitale. Nëse lejohet që kjo mënyrë e funksionimit të vazhdojë më tej nivelet e shërbimit do të vazhdojnë të përkeqësohen dhe në fund të fundit do të rezultojnë me kolaps të gjerë të sistemit. Ne i bëjmë thirrje KRU që të përfshijnë në biznes planet e tyre (si pjesë e rishikimit tarifor 2012-2014) provizionime të mjaftueshme për mirëmbajtje efektive kapitale dhe rritje kapitale dhe të sigurojnë që investimet e planifikuara e të aprovuara nga ZRRUM të zbatohen plotësisht.

---

<sup>22</sup> Shtytja për të përmirësuar eficiencën në arkëtimin e të ardhurave të matur si përqindje e faturimit mund të krijojë stimuj të kundërt për menaxherët komercial të KRU që 'mos të faturojnë' konsumatorët për të cilët ata mendojnë se nuk kanë gjasa që të paguajnë. Kjo do të reduktonte faturimin dhe rriste përqindjen e shkallës së arkëtimit edhe nëse paraja e gatshme në terma absolute do të zvogëlohej.

## 5 PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË (NH IBËR-LEPENCI)

ZRRUM ka mandatin për Rregullimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit me shumicë për furnizimin e KRU. Në përputhje me këtë ZRRUM ka licencuar NH Ibër-Lepenc për furnizim me ujë me shumicë KRU Mitrovica (Mitrovicë) dhe KRU Prishtina (Prishtinë). Një përmbledhje e aktiviteteve të kompanisë është prezantuar në Tabela A - 1 në vijim.

**Tabela A - 1 Të dhënat statistikore për NH 'Ibër-Lepenc' (2010)**

Të dhënat statistikore për 2010	Total
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	17,817,840
Faturimi për ujin me shumicë (€)	374,962
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	120,990
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	484,965
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	21

Vlerësimi i performancës së NH Iber-Lepenci është bërë përmes katër treguesve financiar (shih Tabela A - 2 në vijim). Në vitin 2010 është arkëtuar vetëm 32% e vlerës së ujit të faturuar e cila në raport me vitin 2009 ka shënuar rënje, kryesisht si pasojë e arkëtimit të ulët nga KRU Mitrovica (Mitrovicë). Si rrjedhojë e efijencës së ulët të arkëtimit, norma e punës ka qenë e ulët poashtu, duke treguar se me të hyrat e arkëtuara nuk janë mbuluar shpenzimet operative.

**Tabela A - 2 Performanca e NH 'Ibër-Lepenc'**

Treguesi i performancës	2009	2010	Trendi
Shkalla e arkëtimit	82%	32%	Negativ
Norma e punës	0.84	0.77	Negativ
Norma e mbulimit të punës	0.69	0.25	Negativ
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.021	0.027	Negativ



## 6 AKTIVITETET E KKK

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUM është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, duke u përkujdesur që shërbimet e ofruara nga kompanitë e licencuara të jenë në nivelin e standardeve të përcaktuara, dhe se konsumatorët kanë në disponim mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre.

Me qëllim të realizimit të drejtave dhe të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Nenin 6.1 të Rregullës për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (ZRRUM-R-08/ W & S W) është paraparë formimi i komisioneve këshilluese të konsumatorëve (KKK) si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre komisioneve. Në harmoni me këto dispozita, ZRRUM në fund të vitit 2005 pas shqyrtimit të propozimeve nga Kuvendet Komunale, ka bërë themelimin e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 regjione të Kosovës sipas Planit për Konsolidimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave.

Roli dhe përgjegjësitë e KKK konsistojnë në:

- Zgjidhjen e ankesave të parashtruara nga konsumatorët të cilat nuk janë trajtuar dhe zgjidhur nga kompanitë në mënyrë të drejtë për konsumatorin,
- Ndërmarrjen e sondazheve, studimeve dhe anketimeve lidhur me standardet e shërbimeve, me kërkesë të Rregullatorit
- Ofrimin e këshillave për Rregullatorin lidhur me tarifat e shërbimeve.

Gjatë vitit 2010 KKK janë takuar në mënyrë të rregullt, çdo muaj, ku janë mbajtur 77 takime, në të cilat janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve, propozimi për tarifa të KRM, dhe amandamentimi i Rregullave të ZRRUM (Rregulla për KKK dhe Rregulla për Standardet Minimale të Shërbimit).

Table A - 3 CCC Received complaints by category

Ankesat	KKK Prishtinë	KKK Prizren	KKK Pejë	KKK Mitrovicë	KKK Gjakovë	KKK Ferizaj	KKK Gjilan	Totali
Faturimi	14		1		3			18
Faturimi paushall	27				4			31
Tarifat e larta	4	1				2		7
<b>Totali i ankesave</b>	<b>45</b>	<b>1</b>	<b>1</b>		<b>7</b>	<b>2</b>		<b>56</b>
Ankesat e zgjidhura	6	1			2	2		11

Table A - 3 above Nga tabela e lartë shënuar kuptohet se gjatë vitit 2010 KKK kanë shqyrtuar në total 56 ankesa të konsumatorëve, të cilat janë parashtruar nga konsumatorët te kompanitë. Në përgjithësi numri i ankesave të shqyrtuara nga KKK në 2010 ka qenë më i lartë se në 2009.

## 7 SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Ky raport vjetor i performancës për vitin 2010 në mënyrë të qartë ilustron se sektorët e ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë janë ende larg nivelit të kënaqshëm të performancës dhe se ne kemi një rrugë të gjatë përpara për të arritur standardet dhe nivelet e efijencës që priten në një ekonomi të zhvilluar Evropiane. Megjithatë ne besojmë, se suksesi është i arritshëm me kusht që KRU (dhe bordet e tyre), Qeveria e Kosovës, ZRRUM dhe konsumatorët të gjithë të punojnë së bashku. Në veçanti, sfidat e mëposhtme, e të menjëhershme, me të cilat përballet sektori duhet të trajtohet si çështje urgjente:

### *Biznes planet, aplikacionet tarifore dhe caqet për 2012 - 2014*

Rishikimi i ardhshëm tarifar 2012 - 2014 është një mundësi e artë për KRU që të përgatisin biznes planet e tyre rregullatore mirë të menduara të cilat përcaktojnë nevojat e tyre reale për investime, pritjet e kostove operative efijente dhe performancën komerciale, sidomos arkëtimin e të ardhurave. Nuk do të donim të shohim një përsëritje të shqyrtimit të fundit ku më pas planet ishin provuar se kanë qenë shumë joreale e që rezultojë me nën-performancë të gjithanshme në raport me caqet e përcaktuara.

KRU plotësisht duhet të vlerësojnë konceptin se plani është një kontratë 'morale' në mes tyre dhe konsumatorëve të tyre pasi që konsumatorët janë ata që paguajnë për përmirësime të shërbimit (duke përfshirë shpenzimet kapitale) e të cilat KRU moralisht janë të obliguara që t'i ofrojnë.

Ne presim që KRU në periudhën e ardhshme trevjeçare të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të dhënë rezultatet e përcaktuara në planet e tyre. Monitorimi jonë i performancës në të ardhmen do të vlerësohet në detaje, pra performanca e KRU kundrejt premtimeve të tyre ndaj konsumatorëve ashtu siç përcaktohet në planet e tyre.

### *Çasja në financimet kapitale*

Ne vlerësojmë se kërkesat për shpenzime në investimet masive kapitale të KRU nuk mund të financohet nëpërmjet mjeteve vetanake të parasë së gatshme të KRU dhe se burimet e jashtme financiare (kredi dhe grante) janë thelbësore. Ne kemi paraparë, në rishikimin e ardhshëm tarifar 2012-2014, një kthim më të madh në kapital prej 5.3% (reale), që është përafërsisht e barabartë me rreth 8% (nominale) e për të cilën përqindje ne besojmë se është mjaftueshëm e lartë për të financuar kushtet e dala nga kreditë e marra nga donatorët dhe në të njëjtën kohë të plotësojë kërkesat e brendshme të KRU për para të gatshme. I bëjmë thirrje komunitetit të agjencive zhvillimore që KRU t'i shohin si kompani të favorshme për projekte investuese në të ardhmen, sidomos sektorin e ujërave të zeza.

	S.3.A.04	Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	% e vlerësimit sipas planit	Vlera totale në EUR për shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza për konsumatorët komercial dhe institucional në periudhën raportuese pjestuar me vlerën e vlerësuar të shitjes për shërbime të ujërave të zeza sipas biznes planit për të njëjtën periudhë raportimi (përshtatur për inflacion)
Kostoja për njësi	S.3.B.01	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	EUR/m <sup>3</sup>	Kosto totale operative për trajtimin dhe hedhjen e ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me volumin e matur të ujërave të zeza të dërguar për trajtim në impiantet për trajtimin e ujërave të zeza në të njëjtën periudhë
	S.3.B.02	Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	EUR/m <sup>3</sup>	Kosto totale (provizionimet e shp. operativ + dispozitat e mirëmbajtjes kapitale) për trajtimin e ujërave të zeza si dhe hedhjes në periudhën raportuese pjestuar me volumin e ujërave të zeza të dërguara në të njëjtën periudhë
	S.3.B.03	Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale operative për trajtimin dhe hedhjen e ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin e amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në të njëjtën periudhë
	S.3.B.04	Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale (provizionimet e shp. operative + mirëmbajtjes kapitale) të trajtimit dhe hedhjes së ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive nga trajtimi i ujërave të zeza në të njëjtën periudhë
	S.3.B.05	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale operative e grumbullimit të ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive në të njëjtën periudhë
	S.3.B.06	Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale e (provizionimet e shp. operative + mirëmbajtjes kapitale) grumbullimit të ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive në të njëjtën periudhë
	S.3.B.07	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale operative e aktivitetit biznesor të shërbimeve për ujëra të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve në të njëjtën periudhë
	S.3.B.08	Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	EUR/ kons. shtëpiak	Kosto totale (provizionimet e shp. operative + të mirëmbajtjes kapitale) të aktivitetit biznesor për shërbimet e ujërave të zeza në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive në të njëjtën periudhë
Shpenzimet kapitale	S.3.C.01	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	EUR	Shpenzimet totale të mirëmbajtjes kapitale (përtrritjet e aseteve infrastrukturore + investimet në mirëmbajtjen kapitale jo-infrastrukturore).
	S.3.C.02	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	% e vlerësimit sipas planit	Shpenzimet totale të mirëmbajtjes kapitale (përtrritjet e aseteve infrastrukturore + investimet në mirëmbajtjen kapitale jo-infrastrukturore) pjestuar me përtrritjet e aseteve infrastrukturore dhe provizionimet e shpenzimeve aktuale të zhvlerësimit të aseteve paraqitur në biznes plane.
	S.3.C.03	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	% e BRA	Shpenzimet totale të mirëmbajtjes kapitale (përtrritjet e aseteve infrastrukturore + investimet në mirëmbajtjen kapitale jo-infrastrukturore) pjestuar me bazën rregullatore të aseteve për asetet e ujërave të zeza.
	S.3.C.04	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	EUR	Totali shpenzimeve të rritjes së kapitalit (ritja në asetet infrastrukturore + investimet në përtrritjet kapitale jo-infrastrukturore)
	S.3.C.05	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	% e vlerësimit sipas planit	Totali shpenzimeve të rritjes së kapitalit (ritja e aseteve infrastrukturore + investimet në rritjen e kapitalit jo-infrastrukturor) pjestuar me provizionimet e rritjes së aseteve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore që i takojnë të ujërave të zeza paraqitur në planin e biznesit
<b>F – Financiar</b>				
<b>Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave</b>				
Shitjet	F.1.A.01	Totali i shitjeve	EUR	Vlera totale e shërbimeve (ujë dhe ujëra të zeza) të shitura (faturuara) duke përfshirur taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera në periudhën raportuese.
	F.1.A.02	Totali i shitjeve në raport me planin	% e vlerësimit sipas planit	Vlera totale e shërbimeve (ujë dhe ujëra të zeza) të shitura (faturuara) duke përfshirur taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera në periudhën raportuese pjestuar me totalin e shitjeve të vlerësuara në planin e biznesit për të njëjtën periudhë
Eficienca e arkëtimit	F.1.B.01	Totali i të ardhurave të arkëtuara	EUR	Paraja e gatshme e marrë nga shitjet e ujit (duke përfshirur ngarkesat e kyçjes dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese.
	F.1.B.02	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave	EUR	Totali i parasë së gatshme të marrë nga shitjet e ujit (duke përfshirur ngarkesat e kyçjes dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese minus paraja e gatshme nga shitjet e pritura në planin e biznesit gjatë të njëjtës periudhë
	F.1.B.03	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)	% e vlerësimit sipas planit	Totali i parasë së gatshme të marrë nga shitjet e ujit (duke përfshirur taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese pjestuar me paranë e gatshme nga shitjet e pritura në planin e biznesit në të njëjtën periudhë
	F.1.B.04	Totali i të ardhurave të shlyera	EUR	Totali i të ardhurave të shlyera (duke përfshirur taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera) në pajtueshmëri me URRK në periudhën raportuese
	F.1.B.05	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit	% e faturimit	Totali i të ardhurave të shlyera në pajtueshmëri me URRK në periudhën raportuese pjestuar me totalin e shitjeve (duke mos përfshirë taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera) gjatë të njëjtës periudhë.
	F.1.B.06	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin	% e faturimit	Totali i pranuar i parasë së gatshme nga shitjet e ujit (duke përfshirur taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese pjestuar me faturimin total (duke mos përfshirë taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera)

Sesioni	Ref	Treguesi	Njësi	Definicioni
	F.1.B.07	Llogaritë e arkëtueshme	EUR	Totali i kontove të arkëtueshme pas shlyerjeve (jo më të vjetra se 12 muaj) nga shitjet e faturuara (duke përfshirë taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese
	F.1.B.08	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin	Qarkullimi në ditë	Totali i kontove të arkëtueshme pas shlyerjeve (jo më të vjetra se 12 muaj) nga shitjet e faturuara (duke përfshirë ngarkesat për kyçje dhe të ardhurat tjera) në periudhën raportuese pjestuar me faturimin total (duke përfshirë taksat për kyçje dhe të ardhurat tjera)
<b>Vlerat kyçe financiare dhe normat</b>				
Vlerat	F.2.A.01	Free cash floë	EUR	Totali neto i qarkullimit të parasë së gatshme nga operimet në periudhën raportuese
Normat	F.2.B.01	Rjedha e lirë e parasë së gatshme	EUR	Të hyrat totale neto prej aktiviteteve operative para interesit, dividendës dhe taksës korporative pjestuar për bazën rregullatore të asteve (BRA) gjatë periudhës raportuese.
	F.2.B.02	Kthimi në kapital	%	Totali i pagesës së interesit gjatë periudhës raportuese pjestuar me vlerën mesatare të borxhit në periudhën raportuese.
	F.2.B.03	Kosto e borxhit	%	Borxhi afatgjatë i pjestuar me bazën rregullatore të aseteve (një devijim i vogël nga leva financiare siç është e definuar në kontabilitetin e zakonshëm financiar)
	F.2.B.04	Leva financiare	normë	Neto qarkullimi i parasë së gatshme para interesit dhe taksave pjestuar me pagesën e interesit në periudhën raportuese.
	F.2.B.05	Mbulesa e interes të parasë së gatshme	normë	Qarkullimi neto i parasë së gatshme nga aktivitetet operative para pagesës së taksës dhe interesit, të gjitha të pjestuara me borxhin neto
	F.2.B.06	Fondet nga operacionet/borxhi	normë	Neto qarkullimi i parasë së gatshme nga aktivitetet operative para pagimit të interesit dhe ripagimit të kryeqjës, të gjitha të pjestuara me shërbimin e borxhit (interesi dhe ripagimi i kryeqjës)

## B Arsyeshmëria e matjes së performancës

Kriteret e matjes së performancës së shërbimit të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të zeza janë të tilla që një rezultat 100% pasqyron sigurimin e nivelit të shërbimit krahasuar me një performancë moderne të shërbimeve efikase dhe funksionale të furnizimit me ujë.

### *Struktura e matjes së performancës*

Grupi	Matja e performances	Pesha e rëndësisë së nën-grupit		Pesha e rëndësisë së grupit		
Furnizimi me ujë	Cilësia e ujit të pijshëm	30%	100%		45%	100%
	Shtypja	5%				
	Disponueshmëria	35%				
	Mbulimi me shërbime	20%				
	Efiçienca në arkëtim	10%				
Ujëra të zeza	Cilësia e shkarkimit	20%	100%		35%	100%
	Besueshmëria	20%				
	Mbulimi me shërbime	50%				
	Efiçienca e kostos	10%				
Financiar / komercial	Profitabiliteti			10%	20%	
	Efiçienca komerciale			10%		



### Kriteret, definicionet, koeficienti dhe kalkulimet për matjen e performancës

Parametri	Kriteret për matjen e performancës
<b>Matja e performancës të Furnizimit me ujë</b>	
Cilësia e ujit	<p><u>Definicioni:</u> Kombinimi i performancës së testeve bakteriologjike dhe fizike / kimike në bazë të koeficient krahasues 75:25.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 30%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [ U.1.A.01 x 0.75 + U.1.A.02 x 0.25 ] x 30%</p>
Presioni	<p><u>Definicioni:</u> Përqindja e pronave të paprekura nga presioni që bie nën nivelet e presionit minimal dhe testet e performancës fizike / kimike në bazë të koeficient krahasues 75:25.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 5%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [100% - U.1.A.04] x 5%</p>
Disponueshmëria	<p><u>Definicioni:</u> Definuar si përqindje (e rregulluar) e pronave të paprekura nga furnizime të çrregullta. Ky tregues është i rregulluar për të reflektuar shkallën me të cilin ata që janë të prekur nga ndërprerjet e furnizimit janë të prekur nga peshimi/koeficienti i numrit të amvisërive me furnizim më të pakët se 18 orë me faktorin prej 2.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 35%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [100% - 0.5 x U.1.A.08 - U.1.A.10] x 35%</p>
Shtrirja e shërbimit	<p><u>Definicioni:</u> Përqindja e popullatës në zonën e shërbimit që shërbehet me furnizim me ujë të pijshëm.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 20%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [U.2.A.02] x 20%</p>
Efiçenca e kostos	<p><u>Definicioni:</u> Kosto për njësi e ujit të shitur krahasuar me koston e vlerësuar për njësi gjatë rishikimit tarifor (<math>U_{ET}</math>) (duke përfshirë kthimin në kapital). Kostoja për njësi më e vogël ose e barabartë me 90% të <math>U_T</math> do të merr 100% dhe kostoja për njësi e barabartë ose që e tejkalon 140% të <math>U_{ET}</math> do të merr 0%. Kostot e njësisë në mes 90% dhe 140% of <math>U_{ET}</math> kalkulohehen proporcionalisht.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 10%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> Nëse <math>W.3.B.03 \geq 140\% \times U_{ET} = 0\%</math> ose Nëse <math>W.3.B.03 \leq 90\% \times U_{ET} = 100\% \times 10\% = 10\%</math> Të tjerët [[140% x <math>U_{ET}</math> - <math>\dot{E}.3.B.03</math>] / 50%] x 10%</p>
<b>Matja e performancës së shërbimit të Ujërave të zeza</b>	
Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	<p><u>Definicioni:</u> Pasi që nuk ndërmerret monitorimi i cilësisë së efluentit do të aplikohet një tregues zëvendësues i bazuar në përqindjen e popullsisë së shërbyer nga shërbimet për trajtimin e ujërave të zeza (duke përfshirë gropat septike mire funksionuese në zonat rurale dhe gjysëm rurale).</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 20%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [S.2.A.04] x 20%</p>
Besueshmëria	<p><u>Definicioni:</u> Numri vjetor i incidenteve të tejngarkesës së kanalizimeve per 100 km të gypave krahasuar me nivelin ideal prej 0 deri në maksimum 100</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 20%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> Nëse <math>S.1.B.02 \geq 100 = 0\%</math> Të tjerët [100 - S.1.B.02 ] x 20%</p>
Shtrirja e shërbimit	<p><u>Definicioni:</u> Përqindja e popullsisë në zonën e shërbimit që shërbehet me një sistem të kanalizimit (duke përfshirë ato që përdorin gropat septike në zonat rurale dhe gjysëm rurale).</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 50%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [S.2.A.02] x 50%</p>

Parametri		Kriteret për matjen e performancës
Efienca e koston		<p><u>Definicioni:</u> E definuar si kosto për njësi për shërbimet e ujërave të zeza për amvisëritë e shërbyera krahasuar me koston për njësi të vlerësuar në rishikimin tarifor (<math>U_{ST}</math>) (duke përjashtuar kthimin në kapital). Kosto për njësi më e vogël ose e barabartë me 90% të <math>U_{ST}</math> do të merr 100% dhe kostoja për njësi e barabartë ose që tejkalon 140% e <math>U_{ST}</math> do të merr 0%. Kostot për njësi në mes 90% dhe 140% të <math>U_{ST}</math> janë të kalkuluara proporcionalisht</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 10%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> Nëse <math>W.3.B.03 \geq 140\% \times U_{ST} = 0\%</math> ose Nëse <math>W.3.B.03 \leq 90\% \times U_{ST} = 100\% \times 10\% = 10\%</math> Të tjerët <math>[(140\% \times U_{ST} - \dot{E}.3.B.03) / 50\%] \times 10\%</math></p>
<b>Shërbimet e përbashkëta dhe matja e performancës komerciale</b>		
Furnizimi me ujë		<p><u>Definicioni:</u> Poentimi i performancës së ujit i shumëzuar me koeficientin e përgjithshëm të performancës</p> <p><u>Koeficienti i përgjithshëm i performancës:</u> 45%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [Poentimi i performancës së ujit] x 45%</p>
Shërbimet me Ujëra të zeza		<p><u>Definicioni:</u> Poentimi i performancës së shërbimeve për ujëra të zeza i shumëzuar me koeficientin e përgjithshëm të performancës</p> <p><u>Koeficienti i përgjithshëm i performancës:</u> 35%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> [Poentimi i performancës për ujëra të zeza] x 35%</p>
Financiare / komerciale efienca e koston	Profitabiliteti	<p><u>Definicioni:</u> Kthimi në kapital ashtu siç është i përcaktuar në llogaritë rregulatore pjestuar me kthimin në kapital të dhënë në rishikimin tarifor (<math>ROC_T</math>)</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 10%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> Nëse <math>F.2.B.02 \leq 0\% = 0\%</math> ose Nëse <math>F.2.B.02 \geq ROC_T = 10\%</math> Të tjerët <math>[F.2.B.02 / ROC_T] \times 10\%</math></p>
	Eficienca komerciale	<p><u>Definicioni:</u> Efienca e arkëtimit të të ardhurave sipas matjes së të ardhuravë të arkëtuara pjestuar me totalin e faturimit me një rang prej 60% që është e barabartë me performancën zero deri në maksimumin prej 100% që është performanca ideale.</p> <p><u>Koeficienti i performancës sipas kategorisë:</u> 10%</p> <p><u>Kalkulimi:</u> Nëse <math>F.1.B.06 \leq 60\% = 0\%</math> ose Nëse <math>F.2.B.02 \geq 100\% = 10\%</math> Të tjerët <math>[F.2.B.02 - 60\%] / 40\% \times 10\%</math></p>

# SHTOJCA 3 Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave

Këto pasqyra të të ardhurave përmbledhëse janë përgatitur bazuar në informacionet dërguar ZRRUM në përputhje me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator. Dallimet kryesore mes sistemit të kontabilitetit konvencional dhe UKRR që kompanitë është dashtë t'i adoptojnë janë:

1. Të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me aktivitetet jo-themelore<sup>23</sup> (aty ku ka qenë e mundshme të identifikohen) nuk janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.
2. Në vend të zhvlerësimit këto pasqyra sigurojnë që mirëmbajtja kapitale të realizohet përmes shpenzimeve të përtritjes infrastrukturore dhe zhvlerësimi i **kostos së tanishme** të përcaktohet përmes Bazës Rregullatore të Aseteve (BRA)
3. Provizionimi i borxheve të këqija është definuar si diferencë në mes të faturimit dhe arkëtimit nga viti i kaluar.

Këto pasqyra janë të pa-audituar dhe janë paraqitur si informacione treguese të performancës së KRU. Deri sa KRU të përgatisin pasqyra të audituara, në përputhje me UKRR nuk mund të jepet garanci për saktësinë dhe besueshmërinë e këtyre pasqyrave.

## KRU Prishtina (Prishtinë)

	2010	2009
Qarkullimi	11,003,514	10,033,390
Shpenzimet operative	6,415,256	6,197,879
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>4,588,258</b>	<b>3,835,511</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	174,006	160,591
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>4,414,252</b>	<b>3,674,920</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	3,614,898	3,148,678
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>799,354</b>	<b>526,242</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>799,354</b>	<b>526,242</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>799,354</b>	<b>526,242</b>

## KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

	2010	2009
Qarkullimi	2,861,044	2,734,760
Shpenzimet operative	2,089,601	1,889,153
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>771,443</b>	<b>845,607</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	47,243	45,680
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>724,200</b>	<b>799,927</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	1,101,744	873,553
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>(377,544)</b>	<b>(73,626)</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>(377,544)</b>	<b>(73,626)</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>(377,544)</b>	<b>(73,626)</b>

<sup>23</sup> Për një shpjegim më të saktë e inflacionit bazë dhe jo-thelbësore aktivitetet ju lutem referojuni Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator ZRRUM

## KRU Hidrodrini (Pejë)

	2010	2009
Qarkullimi	2,698,280	2,390,289
Shpenzimet operative	1,526,327	1,430,695
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>1,171,954</b>	<b>959,594</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	38,200	37,143
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>1,133,754</b>	<b>922,451</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	950,755	758,259
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>182,998</b>	<b>164,192</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>182,998</b>	<b>164,192</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>182,998</b>	<b>164,192</b>

## KRU Mitrovica (Mitrovicë)

	2010	2009
Qarkullimi	2,527,853	2,699,989
Shpenzimet operative	1,849,015	1,807,515
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>678,838</b>	<b>892,474</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	21,040	20,708
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>657,798</b>	<b>871,766</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	1,066,247	913,550
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>(408,448)</b>	<b>(41,784)</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>(408,448)</b>	<b>(41,784)</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>(408,448)</b>	<b>(41,784)</b>

## KRU Radoniqi (Gjakovë)

	2010	2009
Qarkullimi	2,654,977	2,615,478
Shpenzimet operative	1,917,234	1,788,139
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>737,743</b>	<b>827,339</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	68,110	67,233
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>669,633</b>	<b>760,106</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	820,280	712,134
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>(150,646)</b>	<b>47,973</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>(150,646)</b>	<b>47,973</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>(150,646)</b>	<b>47,973</b>

## KRU Bifurkacioni (Ferizaj)

	2010	2009
Qarkullimi	1,164,327	1,018,983
Shpenzimet operative	632,884	525,337
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>531,443</b>	<b>493,646</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	20,504	19,869
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>510,939</b>	<b>473,777</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	378,816	391,597
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>132,123</b>	<b>82,180</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>132,123</b>	<b>82,180</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>132,123</b>	<b>82,180</b>

## KRU Hidromorava (Gjilan)

	2010	2009
Qarkullimi	1,589,335	1,467,519
Shpenzimet operative	1,015,805	1,031,718
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>573,530</b>	<b>435,801</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	37,228	36,226
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>536,302</b>	<b>399,575</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	562,726	302,615
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>(26,424)</b>	<b>96,960</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>(26,424)</b>	<b>96,960</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>(26,424)</b>	<b>96,960</b>

## SHTOJCA 4 Pasqyrat tarifore (2009 - 2011)

Tarifat e mëposhtme janë zbatuar në vitin 2009, 2010 dhe aktualisht janë duke u zbatuar në vitin 2011. Këto lista nuk përfshijnë tarifat lidhje. Për detaje të mëtejshme ju lutemi t'i referoheni faqes ëeb-ZRRUM për urdhërat e tarifave.

### Pasqyra tarifore për 2009

	Njësia	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
<b>Konsumatorët shtëpiak</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.30	0.22	0.17	0.28	0.27	0.25	0.28
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.03	0.04	0.05	0.05	0.05	0.09	0.07
<b>Konsumatorët Komercial dhe Institucional</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.72	0.46	0.41	0.7	0.57	0.6	0.6
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.07	0.08	0.07	0.13	0.11	0.14	0.10

### Pasqyra tarifore për 2010

	Njësia	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
<b>Konsumatorët shtëpiak</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.32	0.24	0.18	0.29	0.28	0.27	0.29
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.04	0.04	0.05	0.05	0.05	0.10	0.07
<b>Konsumatorët Komercial dhe Institucional</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.76	0.51	0.42	0.72	0.62	0.62	0.62
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.09	0.08	0.08	0.13	0.11	0.15	0.11

### Pasqyra tarifore për 2011

	Njësia	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
<b>Konsumatorët shtëpiak</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.34	0.27	0.19	0.29	0.29	0.28	0.30
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.04	0.04	0.05	0.06	0.05	0.11	0.07
<b>Konsumatorët Komercial dhe Institucional</b>								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m <sup>3</sup>	0.81	0.57	0.43	0.73	0.64	0.64	0.64
Tarifa për Ujëra të zeza (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m <sup>3</sup>	0.10	0.08	0.09	0.15	0.11	0.18	0.12

# SHTOJCA 5 Detajet kontaktuese

## Kompanitë rajonale të ujit

KRU	Shefi Ekzekutiv	Nr. i telefonit	E-mail adresa	Adresa
KRU Prishtina (Prishtinë)	Gjelosh Vataj (Ushtrues detyre)	038/540 749 Loc.128	gjelosh.vataj@kur-prishtina.com	Rr. Tahir Zajmi, PN , Prishtinë 10000
KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)	Besim Baraliu	029/244 150	besimbaraliu@hotmail.com	Rr. Vatra Shqiptare, Prizren, 20000
KRU Hidrodrini (Pejë)	Agron Tigani	039/432 355	a.tigani@hidrodrini.com	Rr. Gazmend Zajmi nr.5, Pejë 30000,
KRU Mitrovica (Mitrovicë)	Faruk Hajrizi	028/533 707	farukhajrizi@gmail.com	Rr. Bislim Bajgora , PN, Mitrovicë 40000
KRU Radoniqi (Gjakovë)	Albert Zajmi (Ushtrues detyre)	0390/320 503	albert_zajmi@yahoo.com	Rr. UÇK, nr.07, Gjakovë, 50000
KRU Hidromorava (Gjilan)	Myrvete Hoti	0280/321 104	myrvetej@yahoo.com	Rr. UÇK, PN, Gjilan 60000
KRU Bifurkacioni (Ferizaj)	Faton Frangu	0290/320 650	faton_frangu@yahoo.com	Rr. Enver Topalli, nr.42/A, Ferizaj, 70000
NPH Ibër-Lepenc	Hajdar Beqa	038/225 007	hajdarbeqa@gmail.com	Rr. Bill Klinton nr.13, Prishtinë, 10000

## Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Mbeturina


ZRRUM	Emri	Nr. i telefonit	E-mail adresa	Adresa
Drejtori	Raif Preteni	038/249 165/111	raif.preteni@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Zëvendës Drejtori	Kero Bardhaj	038/249 165/124	kero.bardhaj@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Kryesues i departamentit për Ligj dhe Licenca	Mejreme Cërnobregu	038/249 165/117	mejreme.cernobregu@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Kryesues i departamentit për monitorim dhe raportim	Qamil Musa	038/249 165/121	qamil.musa@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Kryesues i departamentit për tarifa dhe financa rregullatore	Sami Hasani	038/249 165/120	sami.hasani@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Kryesues i departamentit për administrim dhe financa	Ramiz Krasniqi	038/249 165/110	ramiz.krasniqi@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000
Personai kontaktues për konsumatorët	Sylë Sylja	038/249 165/124	syle.sylja@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtina, 10000

## Komisionet këshilluese të konsumatorëve

KKK	Emri	Pozita	Kuvendi Komunal	Nr. kontaktues
KKK Prishtina	Teuta Rugova	Kryetar	Prishtinë	044/158 989
	Kadri Shalaku	Anëtar	Obiliq	044/556 688
	Jasmine Hysaj	Anëtar	Shtime	044/044 193
	Hamdi Qerimi	Anëtar	Fushë Kosovë	044/299 025
	Arsim Ajvazi	Anëtar	Podujevë	044/123 529
	Sasha Zdravković	Anëtar	Graçanicë	049/776 585
	Burim Kastrati	Anëtar	Drenas	044/552 890
	Xhelal Limani	Anëtar	Lipjan	044/932 626
KKK Prizreni	Fejsal Hoti	Kryetar	Prizren	044/268 597
	Berat Berisha	Anëtar	Suharekë	044/218 230
	Hamzi Huljaj	Anëtar	Dragash	044/201 039
	Fikret Morina	Anëtar	Mamushë	045/270 744
	Hasan Mazreku	Anëtar	Malishevë	044/890 311
KKK Peja	Drita Kelmendi-Kukaj	Kryetar	Pejë	044/298 803
	Muhamet Raxhaj	Anëtar	Istog	044/138 634
	Zenel Kuqi	Anëtar	Junik	044/134 051
	Sadri Lokaj	Anëtar	Deçan	044/134 123
	Liridon Hoxhaj	Anëtar	Klinë	044/231 165
KKK Mitrovica	Fatime Krasniqi	Kryetar	Mitrovicë	044/773 832
	Agron Lushtaku	Anëtar	Skenderaj	044/192 393
	Sevdije Sadiku	Anëtar	Vushtri	044/732 053
KKK Gjakova	Musë Gjergjaj	Kryetar	Gjakovë	044/307 890
	Florian Hasku	Anëtar	Rahovec	044/200 691
KKK Ferizaj	Zekri Bytyçi	Kryetar	Ferizaj	044/756 233
	Zymer Bushi	Anëtar	Hani i Elezit	044/224 904
	Afrim Bajrami	Anëtar	Kaçanik	044/183 563
	Igor Nikolqeviq	Anëtar	Shtërpcë	045/446 111
KKK Gjilani	Burbuqe Zymberi	Kryetar	Gjilanë	044/370 040
	Haxhi Qerimi	Anëtar	Viti	044/209 908
	Mirvete Rashiti	Anëtar	Kamenicë	044/368 749
	Ivica Radiq	Anëtar	Klllokot	044/357 724
	Dragan Aleksiq	Anëtar	Ranillug	045/482 146
	Sami Vllasaliu	Anëtar	Novoberdë	044/293 279
	Dejan Jociq	Anëtar	Partesh	044/376 788



## SHTOJCA 6 Zonat e shërbimit të KRU



KUR Prishtina	KUR Hidroregjioni Jugor	KUR Hidrodrini	KUR Mitrovica	KRU Radoniqi	KRUK Bifurkacioni	KRUK Hidromorava	Komunitat jashtë shërbimeve nga KUR-të
							
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Shtime -Graçanica	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Klina -Istogu -Juniku -Deqani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novoberda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca



## **B SEKTORI I MBETURINAVE**

---



# 1 ZHVILLIMET NË SEKTORIN E MBETURINAVE

---

Mbeturinat janë një nga problemet më shqetësuese mjedisore të vendit. KRM janë të angazhuara në sektorin e mbeturinave përmes sistemit të mbledhjes, transportit, dhe hedhjes në deponitë e tyre sanitare dhe KMDK është përgjegjëse për menaxhimin e deponive të licencuara sanitare. Sektori i grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale në Kosovë është i karakterit publik, dhe realizohet nga shtatë kompani rajonale të licencuara për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të cilat ofrojnë shërbime në 33 komuna të Kosovës, si dhe një kompani qendrore e licencuar për menaxhimin me deponitë e Kosovës.

Ligji për Ndërmarrje Publike (NR.03/L-87) i definon Komunitetet si pronare të Kompanive Rajonale të cilat ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave komunale, përdoruesit Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), është në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

Në vitin 2010, është intensifikuar bashkëpunimi në mes të Komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Është inkurajuese se ato janë të vetëdijshme për rëndësinë e konceptit të vendosur të organizimit rajonal të sektorit dhe kanë thelluar bashkëpunimin në nivel rajonal me qëllim të zgjidhjes së problemit të mbeturinave duke qenë të bindura se kjo është mënyra më e mirë për përfitimin dhe realizimin e projekteve të kësaj fushe dhe gjetjen e donatorëve të ndryshëm të cilët janë të interesuar për investime, sidomos në projektet për riciklimin e mbeturinave.

Participimi i Sektorit Privat (PSP) në mbledhjen dhe transportin e mbeturinave ende nuk është i legalizuar. Ai aktualisht është aktiv në fshirjen dhe pastrimin e rrugëve përdoruesit është duke u ushtruar një presion i vazhdueshëm nga ana e tyre që të kryejnë shërbime në mbledhjen dhe transportin e mbeturinave. Pothuajse në të gjitha zonat e shërbimit të KRM, operojnë një numër i operatorëve privat të cilët ofrojnë shërbime duke zgjedhur konsumatorët dhe zonat të cilat ju garantojnë një operim eficient dhe pagesa të larta të shërbimeve-fakt ky që ka shkaktuar shqetësim dhe pengesa në operimin e kompanive publike. Në lidhje me këtë çështje, Qeveria e Kosovës, fillimisht është duke u angazhuar për hapjen e rrugës për participimin e sektorit privat në menaxhimin e deponive rajonale në Kosovë, në mënyrë që të përmirësojë infrastrukturën në mënyrë thelbësore dhe ofrimin e shërbimeve më të mira duke u siguruar se infrastruktura dhe shërbimet do të ofrohen në mënyrë sa më efikase dhe me kosto sa më të volitshme. Procesi i participimit të sektorit privat mbështetet nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), e cila do të nxjerr propozime dhe opsione më të pranueshme në mënyrë që përmes sektorit privat të realizohen investime substanciale dhe të fuqishme në këtë sektor dhe në të njëjtën kohë të sigurohet menaxhim efikas dhe profesional i deponive rajonale në Kosovë.

Në sektorin e mbeturinave komuniteti i donatorëve është duke dhënë një mbështetje të madhe përmes projekteve të ndryshme në menaxhimin e mbeturinave kryesisht në ngritje institucionale dhe të paisjeve. USAID përmes Projektit për Iniciativën Demokratike të Komunave Efektive (DEMI), në disa prej komunave të Kosovës për disa vite është duke dhënë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të Komunave përveç tjerash edhe në menaxhimin e mbeturinave. Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar në vitin 2010 ka ndihmuar me investime të konsiderueshme, përmes projekteve për menaxhimin dhe riciklimin e mbeturinave, Komunitetet e Prizrenit dhe Prishtinës. Kjo mbështetje planifikohet të zgjerohet edhe në komunitetet tjera.

Pjesa B e këtij raporti paraqet performancën e shtatë kompanive të licencuara për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe performancën e kompanisë menaxhuese të deponive në Kosovë. Vlerësimi i performancës, si për sektorin e poashtu edhe për kompanitë individuale, është i njëjtë me qasjen e adoptuar në raportet e më hershme.

## 2 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË MBETURINAVE

Shtrirja me shërbime e ofruar nga KRM, gjatë vitit 2010, ka qenë 48% që në krahasim me vitin 2009 është për 5% më e lartë. Kompanitë publike kryesisht ofrojnë shërbime në zonat urbane përderisa në zonat rurale (fshatra) shërbimet janë të kufizuara në vetëm një numër sosh. Padyshim se një nga synimet kryesore të shërbimeve komunale të mbeturinave duhet të jetë rritja e mbulesës së shërbimit e cila aktualisht është në nivel shumë të ulët.

Grumbullimi vjetor i mbeturinave të ngurta është rritur në 252,111 ton në vitin 2010 nga 245,961 ton sa ishte në vitin 2009. Të gjitha KRM kanë në dispozicion gjithsej 189 automjete, përfshirë traktorë dhe kamion të tipeve të ndryshme të cilat kryesisht janë në gjendje të vjetruar dhe ndikojnë dukshëm në produktivitetin e KRM. Po ashtu është evidente se numri i automjeteve në shumicën e kompanive është i pamjaftueshem. Shtatë KRM në Kosovë kanë të punësuar 1,460 punëtorë përmes të cilëve i'u sigurohen shërbime rreth 151.566 konsumatorëve (përfshirë konsumatorët shtëpiak, komercial-industrial dhe institucional), të cilët janë të angazhuar kryesisht në mbledhjen dhe transportin e mbetjeve të ngurta komunale në kuadër të një zone të caktuar, si dhe të disa aktiviteteve dytësore. Në 2010 Efikasiteti i stafit ka qenë 173 ton mbeturina të grumbulluara për punëtorë.




Figura B - 1 Struktura e shpenzimeve operative për sektor

Shpenzimet e stafit kanë pasur pjesëmarrje më të lartë në totalin e shpenzimeve operative prej 60% (shih më lartë Figura B - 1). Në lidhje me cilësinë e shërbimit në mbledhjen e mbeturinave, është e rëndësishme të theksohet se në 7 KRM frekuenca e mbledhjes është e mjaftueshme. Gjashtë nga shtatë KRM aktivitetet e tyre i realizojnë në dy turne përderisa KRM Uniteti (Mitrovicë) punon në tri turne.

KRM, në bazë të rregulloreve të ZRRUM janë të obliguara që të kenë një sistem të mirëfilltë për pranimin, shqyrtimin dhe zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve, i cili aktualisht nuk është në nivelin e duhur në asnjërën nga KRM.

### 2.1 Metodologjia e vlerësimit të performancës

Vlerësimi kryhet në baza vjetore dhe kalon në tri fazat vijuese: (i) Raportimi i të dhënave në baza mujore përmes sistemit të Raportimit ROFK, (ii) Përpunimi i të dhënave dhe llogaritja e treguesve të performancës, si dhe (iii) Analizimi, krahasimi dhe poentimi i treguesve të performancës sipas një modeli të përvetësuar.

Për të vlerësuar performancën relative të KRM, janë zhvilluar disa Tregues Kyç të Performancës (TKP), të cilët janë ndarë në tri grupe duke përfshirë aspektet teknike, financiare dhe shërbimit me konsumatorë.

Arsyeshmëria e vlerësimit relativ të performancës së KRM është bazuar në përmbledhjen e performancës për TKP e zgjedhur, dhe për të arritur këtë janë përdorur këto kritere: (i) Gjashtë TKP janë përdorur në analizën e përgjithshme. Kompanitë konsiderohet se këta tregues mund të i kontrollojnë dhe të cilët së bashku më së miri pasqyrojnë nivelin e përgjithshëm të shërbimeve të ofruara nga çdo KRM; (ii) TKP janë peshuar me koeficient të ndryshëm varësisht nga rëndësia që ato e kanë në performancën e kompanisë dhe në nivelin e shërbimit për konsumator; dhe (iii) Një (1.0) pikë i është dhënë kompanisë me performancën më të mirë dhe zero (0.0) pikë i është dhënë kompanisë me performancën më të dobët në treguesin e analizuar. Kompanitë e mbetura kanë marrë pikët në mes të 0.0 dhe 1.0 në bazë të ndarjes proporcionale të pikëve varësisht nga niveli i arritur në atë tregues. Totali i pikëve të grumbulluara për një kompani paraqet shumën e pikëve të mbledhura për secilin tregues.

**Tabela B - 1 Performanca e sektorit të mbeturinave 2009-2010**

KRM	Shkalla e arkëtimit (%)	Norma e mbulimit të punës	Përqindja e ankesave të zgjidhura (%)	Kostoja për njësi (Euro/t)	Efikasiteti i stafit (Staf/1000 kon)	Rritja e numrit të konsumatorëve (%)
Sektori në 2009	55	0.87	98.7	32.32	9.26	2.33
Sektori në 2010	61	0.93	99.78	33.48	9.63	-1.37
Trendi	Positiv	Positiv	Positiv	Negativ	Negativ	Negativ

Në përgjithësi sektori ka shënuar trende pozitive në 3 tregues kyç (shih më lartë Tabela B - 1), sidomos në treguesit financiar: Shkalla e arkëtimit dhe Norma e mbulimit të punës, të cilët edhe më së miri pasqyrojnë qëndrueshmërinë financiare të KRM. Plotësimi i standardit për zgjedhjen me kohë të ankesave të konsumatorëve po ashtu ka shënuar progres. Shpenzimet për njësi prej viti në vit janë rritur sidomos për nën-kategorinë e pagave dhe derivateve për nivelin e njëjtë të sigurimit të shërbimeve.

**Tabela B - 2 Treguesit kyç të performancës dhe pesha e tyre**

Treguesi Kyç	Pesha e Treguesit
Shkalla e arkëtimit (%)	1.0
Norma e mbulesës së punës	1.0
Përqindja e ankesave të zgjidhura (%)	1.0
Shpenzimet operative për njësi	0.8
Efikasiteti i stafit(staf/1000kon)	0.8
Përqindja e rritjes së numrit të konsumatorëve (%)	0.2

Tre treguesit më të rëndësishëm, dy financiar dhe një i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimit, janë vlerësuar me 1.0 pikë, dy të tjerë janë vlerësuar me 0.8 ndërsa një peshë simbolike prej 0.2 pikë i është dhënë Rritjes së numrit të konsumatorëve (shih më lartë Tabela B - 2).

**Tabela B - 3 Rangimi i kompanive sipas performancës në vitin 2010**

Pozita	KRM	Pikët e mbledhura
1	KRM Pastërtia	3.59
2	KRM Ambienti	3.23
3	KRM Pastrimi	2.59
4	KRM Çabrati	2.38
5	KRM Higjiena	2.20
6	KRM Ekoregjioni	1.42
7	KRM Uniteti	1.21

Në përgjithësi KRM Pastërtia (Ferizaj) ka shënuar performancë më të mirë në vitin 2010, e cila ka mbledhur 3.59 nga maksimumi prej 4.8 pikëve të mundshme (shih më lartë Tabela B - 3). Performancë më të mirë kjo kompani e ka treguar në Shkallën e arkëtimit, Normën e mbulimit të punës si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e Ankesave të konsumatorëve me kohë, përderisa Shpenzimet për një ton mbeturina të grumbullara i ka më të larta krahasuar me kompanitë tjera. KRM Uniteti (Mitrovicë) është në pozitën e fundit duke treguar performancë të dobët në shumicën e TKP. Numri i pikëve të mbledhura sipas TKP në SHTOJCA 2.

**Tabela B - 4 Rangimi i kompanive sipas përmirësimit të performancës 2009-2010**

Pozita	KRM	Pikët e mbledhura
1	KRM Pastërtia	3.82
2	KRM Ambienti	2.75
4	KRM Pastrimi	2.35
3	KRM Çabrati	2.30
5	KRM Uniteti	1.74
6	KRM Ekoregjioni	1.59
7	KRM Higjiena	0.95

Po ashtu KRM Pastërtia (Ferizaj) ka shënuar edhe përmirësimin më të madh gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009, përderisa KRM Higjiena (Gjilan) ka shënuar progresin më të ulët gjatë kësaj periudhe të analizuar (shih më lartë Tabela B - 4). Numri i pikëve të mbledhura sipas TKP, për progresin e arritur në vitin 2010 si dhe për periudhën 2006-2010 tregohet në SHTOJCA 2.



## 3 PERFORMANCA KRAHASUESE E KOMPANIVE TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

Për të krahasuar performancën e KRM në këtë raport janë shfrytëzuar një numër treguesish të performancës prej të cilëve gjashtë janë Tregues Kyç të Performancës. Treguesit janë grupuar në tri kategori të cilat i përfshijnë aspektet operative, financiare dhe të shërbimit me konsumatorë.

### 3.1 Performanca teknike

Qëllimi i këtij grupi të treguesve është të vlerësojë se sa janë mundësitë operative të kompanisë përfshirë aspektet infrastrukturore dhe njerëzore për të ofruar shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

#### 3.1.1 Grumbullimi i mbeturinave për punëtor

Figura B - 2 në vijim paraqet sasinë e mbeturinave të grumbulluara për punëtor (ton/vit). Në përgjithësi, mesatarja e mbeturinave të mbledhura për punëtor në 2010 ishte 173 ton dhe ka mbetur e njëjtë krahasuar me vitin 2009.





Figura B - 2 Grumbullimi i mbeturinave për punëtor

KRM Pastrimi (Prishtinë), KRM Ekoregjioni (Prizren) dhe KRM Uniteti (Mitrovicë) janë tri kompanitë të cilat kanë performancën më të mirë në këta tregues dhe janë mbi mesataren e sektorit. Eficienca më e mirë e tyre me një diferencë të theksuar në krahasim me kompanitë tjera mund të jetë për faktin se këto kompani kanë shtrirje më të madhe krahasuar me të tjerat (ekonomia e shkallës) por duke mos injoruar edhe faktorët tjerë si disponueshmëria me numër të mjaftueshëm të automjeteve dhe largësia nga deponia.

#### 3.1.2 Mbeturinat e deponuara në deponitë e licensuara

Figura B - 3 në vijim paraqet përqindjen e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare rajonale. Në përgjithësi 87% e mbeturinave të grumbulluara nga KRM, në vitin 2010, janë deponuar në deponitë sanitare rajonale, kjo është për 3% më shumë se sa në vitin 2009. KRM Uniteti (Mitrovicë)<sup>24</sup>, KRM Higjiena (Gjilan) dhe KRM Pastërtia (Ferizaj) të gjitha mbeturinat e grumbulluara i dërgojnë në deponitë sanitare përdërisa tri kompanitë tjera si: KRM Pastrimi (Prishtinë), KRM Ekoregjioni (Prizren) dhe KRM Ambienti (Pejë) një sasi të mbeturinave e dërgojnë në deponitë e egra.

<sup>24</sup>KRM Uniteti (Mitrovicë) dhe KRM Ambienti (Pejë) nuk janë të licensuar nga ZRRUM për menaxhim me deponitë sanitare në Mitrovicë dhe Pejë.




**Figura B - 3 Mbeturinat e deponuara në deponitë rajonale**

Në rajonin e Gjakovës, në vitin 2010, është ndërtuar stacioni i transferit të mbeturinave dhe KRM Çabrati (Gjakovë) ka filluar shfrytëzimin e saj në të njëjtin vit.

Problem në vete paraqet pamundësia e KRM për të paguar në tërësi KMDK për hedhjen e mbeturinave, si pasojë e gjendjes së dobët financiare.

### 3.1.3 Efikasiteti i stafit

Figura B - 4 në vijim paraqet efikasiteti e stafit për 1000 konsumatorë.



**Figura B - 4 Efikasiteti i stafit**

